



Manual për Ndjekjen e Zbatimit të Rekomandimeve për Zgjedhjet

Botuar nga Zyra e OSBE-së për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut
(ODIHR)
Ul. Miodowa 10
00-251 Varshavë,
Poloni.
www.osce.org/odhr

© OSCE/ODIHR 2018

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Përmbajtja e këtij botimi mund të përdoret dhe të kopjohet lirisht për qëllime edukative dhe jokomerciale, me kusht që çdo riprodhim i tillë të shoqërohet me një shënim ku të thuhet se burimi është OSBE/ODIHR-i.

ISBN 978-92-9234-982-0

Fotografia e kopertinës nga OSBE/Jonathan

Formulimi grafik nga Nona Reuter

Shtypur në Poloni nga Centrum Poligrafii Sp. z o.o

Pasqyra e lëndës

Parathënie	5
1. Introduction	7
1.1 Rreth këtij manuali	7
1.2 Si përdoret ky manual	8
2. Konteksti i ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve për zgjedhjet	11
2.1 Ndjekja e zbatimit të rekomandimeve për zgjedhjet në kontekst	11
2.2 Pse duhen zbatuar rekomandimet për zgjedhjet?	12
2.3 Sfidat në zbatimin e rekomandimeve për zgjedhjet	13
2.4 Ku, çfarë dhe kur duhet të ndiqet zbatimi i rekomandimeve	14
3. Angazhimet e OSBE-së dhe detyrimet e standardet e tjera ndërkombëtare për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve për zgjedhjet	17
3.1 Angazhimet e OSBE-së	18
3.2 Instrumentet universale	20
3.3 Instrumente të tjera rajonale	22
3.4 Standarde të tjera për zbatimin e rekomandimeve	24
3.5 Parimet për zbatimin e rekomandimeve për zgjedhjet	25
4. Angazhimi paszgjedhor: qasja sipas ciklit zgjedhor	27
4.1 Publikimi i raportit përfundimtar	28
4.2 Paraqitja e raportit përfundimtar	29
4.3 Aktivitetet për zbatimin e rekomandimeve për zgjedhjet	30
4.4 Misionet e vlerësimit të nevojave	31
5. Praktika e mirë për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve për zgjedhjet	33
6. Shembuj të aktiviteteve për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve	37
6.1 Aktivitetet për zbatimin e rekomandimeve nga shteti pjesëmarrës	38
6.2 Aktivitetet për zbatimin e rekomandimeve për zgjedhjet nga ODIHR-i	40
7. Partneritetet dhe bashkërendimi në ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve për zgjedhjet	45
7.1 Bashkërendimi me homologët kombëtarë	46
7.2 Bashkërendimi me OSBE-në	47

7.3	Bashkërendimi mes organizatave ndërkombëtare	49
7.4	Bashkërendimi me komunitetin e donatorëve dhe atë diplomatik	52
8.	Vlerësimi i ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve për zgjedhjet	53
9.	Nxitja e pjesëmarrjes së grupeve të papërfaqësuar sa duhet politikisht	57
9.1	Angazhimet e OSBE-së dhe detyrimet ndërkombëtare që nxisin pjesëmarrjen e grupeve të papërfaqësuar sa duhet politikisht	57
9.2	Nxitja e pjesëmarrjes së grupeve të papërfaqësuar sa duhet politikisht në proceset e zbatimit të rekomandimeve dhe në reforma	59
Shtojcat		61
	Angazhimet e OSBE-së dhe detyrimet e standardet e tjera ndërkombëtare për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve për zgjedhjet	62
	Materiale dhe burime të tjera për zbatimin e rekomandimeve	72
Lista e shkurtimeve		74

Parathënie

Në fillim të viteve '90-të, Zyra e OSBE-së për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (ODIHR) filloi vëzhgimin e zgjedhjeve në mbështetje të zhvillimit të proceseve dhe ngritjes së institucioneve demokratike në të gjitha shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së. Që prej asaj kohe, ODIHR-i ka vëzhguar më shumë se 300 zgjedhje dhe aktivitetet e vëzhgimit të zgjedhjeve të kësaj Zyre kanë luajtur një rol të rëndësishëm për nxitjen e transparencës dhe llogaridhënies, si dhe për rritjen e besimit të publikut në proceset zgjedhore.

Megjithatë, vëzhgimi i zgjedhjeve nuk përbën qëllim në vetvete. Që vëzhgimi të ketë një ndikim të konsiderueshëm, ai duhet të ketë si qëllim kryesor ndihmesën për shtetet pjesëmarrëse në zbatimin e angazhimeve dhe detyrimeve të tyre në lidhje me zgjedhjet. Kështu, pjesë thelbësore e vëzhgimit të zgjedhjeve është vlerësimi përfundimtar dhe rekomandimet e dhëna nga ODIHR-i për përmirësimin e zhvillimit të zgjedhjeve. Vëzhgimi i zgjedhjeve mund të jetë i dobishëm vetëm nëse këto rekomandime merren seriozisht dhe zbatohen në mënyrë efektive. Në rast të kundërt, ekziston një rrezik real që mangësitë dhe dobësitë e zgjedhjeve të vazhdojnë dhe, me të gjitha gjasat, të rriten.

Rëndësia e ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve është pranuar vazhdimisht nga shtetet pjesëmarrëse. Për shembull, në Samitin e Stambollit, të vitit 1999, këto shtete u angazhuan për të "zbatuar në mënyrë të menjëhershme vlerësimin dhe rekomandimet e ODIHR-it për zgjedhjet" dhe pranuan "asistencën që ODIHR-i mund t'u ofrojë shteteve pjesëmarrëse në hartimin dhe zbatimin e legjislativioneve të tyre zgjedhore".

ODIHR-i është përpjekur vazhdimisht të nxisë ndjekjen e zbatimit të efektshëm të rekomandimeve për zgjedhjet dhe i ka intensifikuar përpjekjet vitet e fundit. Në përfundim të zgjedhjeve, ne kemi paraqitur rregullisht raportet tona përfundimtare me rekomandime në vendet ku janë mbajtur zgjedhjet, si një mënyrë për të ruajtur një dialog konstruktiv me autoritetet dhe për të diskutuar mënyrat, përmes të cilave mund të ndihmojmë për ndjekjen e zbatimit të këtyre rekomandimeve. Ne, gjithashtu, i mbështesim shtetet përmes analizave ligjore dhe opinioneve të ekspertëve për kuadrin zgjedhor, përmes takimesh dhe tryezash të rrumbullakëta për çështje zgjedhore specifike, si dhe përmes këshillimit teknik për çështje të zbatimit të rekomandimeve.

Për shumë vite, ODIHR-i ka zhvilluar aktivitete sa i përket ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve dhe shpresojmë që ky manual të ndihmojë në krijimin e

një qasje më sistematike, që ofron qartësi dhe vijueshmëri, dhe që inkurajon kushtimin e një vëmendjeje më të madhe ndaj zbatimit të rekomandimeve. Këtë manual e kemi hartuar në kuadër të përpjekjeve të vazhdueshme të ODIHR-it për përmirësimin e metodologjisë sonë dhe rritjen e profesionalizmit në aktivitetet tona për vëzhgimin e zgjedhjeve.

Jemi të bindur se ky manual do të forcojë ndikimin e vëzhgimit dhe cilësisë së aktiviteteve tona për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve në të gjithë rajonin e OSBE-së. Ai duhet të shërbejë si një mjet i dobishëm për shtetet pjesëmarrëse, të interesuara në ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve për zgjedhjet dhe si një orientim praktik për ODIHR-in në mbështetje të shteteve dhe përpjekjeve të tyre.

Dëshirojmë të falënderojmë ekspertët dhe organizatat e shumta që kanë ofruar komente të vyera gjatë gjithë procesit të hartimit të këtij manuali, sidomos homologët tanë që kanë miratuar Deklaratën e Parimeve për Vëzhgimin Ndërkombëtar të Zgjedhjeve. Ky manual nuk do të mund të hartohet pa mbështetjen dhe bashkëpunimin e tyre.

Michael Georg Link
Drejtor i ODIHR-it



1. Hyrje

1.1 Rreth këtij manuali

Në fillim të viteve '90-të, Zyra e OSBE-së për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (ODIHR) filloi punën për vëzhgimin e zgjedhjeve në mbështetje të zhvillimit të proceseve dhe ngritjes së institucioneve demokratike në shtetet pjesëmarrëse. Vëzhgimi i zgjedhjeve ka luajtur një rol të rëndësishëm në të gjithë rajonin e OSBE-së për nxitjen e transparencës dhe llogaridhënies, si dhe për rritjen e besimit të publikut në proceset zgjedhore.

Megjithatë, vëzhgimi i zgjedhjeve nuk përbën qëllim në vetvete; përmes vëzhgimit synohet dhënien ndihmë shteteve pjesëmarrëse për zbatimin e angazhimeve dhe detyrimeve të tyre në lidhje me zgjedhjet. Pjesë thelbësore e vëzhgimit të zgjedhjeve janë rekomandimet e dhëna për përmirësimin e zhvillimit të zgjedhjeve. Vëzhgimi i zgjedhjeve është i dobishëm vetëm nëse këto rekomandime merren seriozisht dhe zbatohen në mënyrë efektive. Kjo është pranuar nga të gjitha shtetet pjesëmarrëse që janë angazhuar në kuadrin

e Dokumentit të OSBE-së, të vitit 1999, në Stamboll për të “zbatuar në mënyrë të menjëhershme vlerësimet dhe rekomandimet e ODIHR-it për zgjedhjet”. Që prej asaj kohe, zbatimi i tyre është bërë gjithnjë e më i rëndësishëm për shtetet pjesëmarrëse, si dhe për punën e ODIHR-it për të mbështetur shtetet në përpjekjet e tyre për përmirësimin e proceseve zgjedhore.

Në këtë manual përcaktohen qasja dhe praktikat që zbaton ODIHR-i për të ndihmuar shtetet pjesëmarrëse lidhur me ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve për zgjedhjet. Ndonëse ODIHR-i ka zhvilluar aktivitete në këtë fushë në disa vite, ky manual ka për qëllim të ndihmojë në krijimin e një qasjeje më sistematike, që ofron qartësi dhe vijueshmëri, dhe nxitjen e një vëmendjeje më të madhe ndaj zbatimit të rekomandimeve. Ai është hartuar në sajë të kontributeve të pakursyera jashtëbuxhetore, në kuadër të përpjekjes së vazhdueshme të ODIHR-it për përmirësimin e metodologjisë së tij dhe për ritjen e profesionalizmit në aktivitetet e vëzhgimit të zgjedhjeve.

Ky manual është hartuar pikë së pari për aktorët në shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së, që shqyrtojnë rekomandimet e ODIHR-it për zgjedhjet, por do të jetë i dobishëm, gjithashtu, për ato vende jashtë rajonit të OSBE-së, që zbatojnë këto rekomandimeve. Manuali është shkruar për autoritetet shtetërore, partitë politike, median, grupet e vëzhguesve qytetarë dhe organizatat e shoqërisë civile (OSHC-të), të përfshira në ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve, si dhe për organizatat e tjera ndërkombëtare.

Për qëllime të këtij manuali, me ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve janë pasur parasysh hapat që ndërmarrin autoritetet shtetërore dhe aktorët joshtetërorë për zbatimin dhe përbushjen e rekomandimeve, që bëjnë misionet e vëzhgimit dhe vlerësimit të zgjedhjeve për respektimin e të drejtave demokratike, për të cilat është marrë angazhim në kuadër të marrëveshjeve politike dhe të traktateve të detyrueshme ligjore. Ndjekja e zbatimit të rekomandimeve përfshin punën për përmirësimin e kuadrit ligjor dhe zhvillimin e zgjedhjeve. Kjo mund të mbështetet nga ODIHR-i dhe nga organizata të tjera ndërkombëtare përmes aktiviteteve të posaçme për zbatimin e rekomandimeve.

1.2 Si përdoret ky manual

Në këtë manual jepet një përmbledhje e elementeve kryesore që përcaktojnë ndjekjen e zbatimit të efektshëm të rekomandimeve për zgjedhjet. Në Kapitullin 2 bëhet një përshkrim i kontekstit të qasjes që ka ODIHR-i ndaj ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve dhe përfitimeve e sfidave që lidhen me të. Në Kapitullin 3 jepet një vështrim të përgjithshëm të angazhimeve të OSBE-së,

detyrimeve ndërkombëtare dhe standardeve të tjera, që nxisin shtetet për të shqyrtuar rekomandimet zgjedhore dhe që përbëjnë bazën për zbatimin e tyre.

Në Kapitullin 4, ndjekja e zbatimit të rekomandimeve trajtohet si në kuadrin e qasjes më të gjerë sipas ciklit zgjedhor, ashtu edhe si pjesë të periudhës më të shkurtër të angazhimit paszgjedhor. Në Kapitullin 5 identifikohen praktikat e mira që mund të rrisin efikasitetin e ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve, kurse në Kapitullin 6 bëhet një përmbledhje e mekanizmave që mund të përdorin shtetet pjesëmarrëse për zbatimin e rekomandimeve për zgjedhjet, dhe parashtrihen me hollësi aktivitetet vijuese që mund të ofrojë ODIHR-i për të mbështetur shtetet në përpjekjet e tyre.

Në Kapitullin 7 jepet një përshkrim i bashkëpunimit të ODIHR-it me homologët kombëtarë dhe me aktorë të tjerë ndërkombëtarë që përfshihen në procesin e ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve për zgjedhjet, si brenda OSBE-së, ashtu edhe jashtë organizatës, kurse në Kapitullin 8 paraqiten mënyrat e vlerësimit të zbatimeve të rekomandimeve të ODIHR-it. Kapitulli 9 ka vënë në qendër nevojën e garantimit të pjesëmarrjes së grupeve të papërfaqësuara sa duhet politikisht në proceset e ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve, si: gratë, pakicat kombëtare dhe personat me aftësi të kufizuara.

Në fund, ky manual përmban tri shtojca. Në Shtojcën A bëhet një përmbledhje e angazhimeve kryesore të OSBE-së, detyrimeve ndërkombëtare e standardeve të tjera që lidhen me ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve. Në Shtojcën B jepet një renditje e burimeve dhe materialeve shtesë që lidhen me ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve. Në Shtojcën C jepet një listë e shkurtimeve të përdorura më shpesh.



2. Konteksti i ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve për zgjedhjet

2.1 Ndjekja e zbatimit të rekomandimeve për zgjedhjet në kontekst

Si një komunitet shtetesh të angazhuara për respektimin e të drejtave të njeriut, demokracisë dhe sundimit të ligjit, OSBE-ja u ka mëshuar zgjedhjeve demokratike si një shtyllë kryesore për sigurinë dhe stabilitetin afatgjatë. Të gjitha shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së janë angazhuar për të ftuar vëzhgues të zgjedhjeve nga shtete të tjera pjesëmarrëse të OSBE-së, ODIHR-i dhe Asambleja Parlamentare e OSBE-së, si dhe nga grupe të vëzhguesve qytetarë.

Aktiviteti i ODIHR-it për vëzhgimin e zgjedhjeve ka për qëllim të vlerësojë shkallën e përputhshmërisë së proceseve zgjedhore me angazhimet e OSBE-së dhe detyrimet e standardet të tjera ndërkombëtare për zgjedhje demokratike, nëse legjislacioni vendas i reflekton këto angazhime dhe se si zbatohet ai në praktikë. Objektivat e vëzhgimit të zgjedhjeve përfshijnë identifikimin e hapësirave për përmirësim dhe formulimin e rekomandimeve konkrete

dhe operative, që do të mbështesin përpjekjet e shteteve pjesëmarrëse në përmirësimin e mëtejshëm të mënyrës së zhvillimit të zgjedhjeve.

Deri tani, ODIHR-i ka realizuar më shumë se 300 aktivitete në lidhje me zgjedhjet në 56 nga 57 shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së, si dhe në disa shtete Partnere për Bashkëpunim të OSBE-së sipas një mandati të posaçëm nga Këshilli i Përhershëm i OSBE-së.¹

2.2 Pse duhen zbatuar rekomandimet për zgjedhjet?

Shtrirja e vëzhgimit të zgjedhjeve gjatë dy dhjetëvjeçarëve të fundit tregon rëndësinë gjithmonë e më të madhe, që po i kushton zgjedhjeve komuniteti ndërkombëtar. Këtu përfshihet interesi politik në rritje për mbështetjen e zhvillimit dhe konsolidimit demokratik, si dhe rritja e ndërgjegjësimit rreth rreziqeve të mëdha që shoqërojnë zgjedhjet problematike, përfshirë rreziqet për sigurinë dhe stabilitetin. Aktivitetet e vëzhgimit të zgjedhjeve kanë rezultuar mjete efikase për vlerësimin e mbajtjes së zgjedhjeve dhe për identifikimin e fushave ku mund të bëhen përmirësime për garantimin e të drejtave demokratike dhe për nxitjen e zhvillimit afatgjatë në fushën e zgjedhjeve.² Rekomandimet që rrjedhin nga aktivitetet për vëzhgimin e zgjedhjeve, përbëjnë një pjesë thelbësore të shërbimit të ofruar nga organizatat që marrin përsipër të bëjnë një vëzhgim të besueshëm të zgjedhjeve, dhe bëhen për të identifikuar mënyrat praktike, në të cilat mund të përmirësohen zgjedhjet, me qëllim përmbushjen e angazhimeve të OSBE-së dhe detyrimeve e standardeve të tjera ndërkombëtare.

Nëse rekomandimet nuk shqyrtohen, mangësitë dhe dobësitë në zgjedhje kanë gjasë të vazhdojnë dhe mund edhe të përkeqësohen. Kjo jo vetëm që vë në rrezik mbrojtjen e të drejtave kryesore të njeriut, por mund të dëmtojë edhe besueshmërinë e perceptuar të procesit zgjedhor dhe të shkaktojë shqetësime sa i takon sigurisë në nivel kombëtar dhe rajonal. Mospërmbushja e rekomandimeve, gjithashtu, mund të çojë në reagime negative nga ana e aktorëve ndërkombëtarë, që kanë interes në nxitjen dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut, duke çuar ndoshta edhe në kufizimin e bashkëpunimit

1 I vetmi shtet pjesëmarrës që mbetet, është Selia e Shenjtë. ODIHR-i ka dërguar ekipet e veta në mbështetje të zgjedhjeve në Afganistan në vitin 2004, 2005, 2009, 2010 dhe 2014. ODIHR-i ka ndërmarrë aktivitete në mbështetje të proceseve zgjedhore në Tunizi, nga viti 2012 deri në vitin 2014.

2 ODIHR-i ka zhvilluar disa formate të ndryshme të aktiviteteve për vëzhgimin e zgjedhjeve për t'iu përgjigjur në mënyrë efektive nevojave të shteteve pjesëmarrëse. Këtu përfshihen Misioni i Vëzhgimit të Zgjedhjeve, Misioni i Kufizuara të Vëzhgimit të Zgjedhjeve, Misioni i Vlerësimit të Zgjedhjeve dhe Ekipi i Ekspertëve. Për më shumë informacion, shih Kapitullin 5 të "Manualit për vëzhgimin e zgjedhjeve" të ODIHR-it (botimi i 6-të). Në këtë manual, termi "mision/aktivitet për vëzhgimin e zgjedhjeve", përveçse kur specifikohet ndryshe, përfshin të gjitha llojet e formateve të misioneve të zgjedhjeve të ODIHR-it.

politik, ndihmës për zhvillim apo tregtisë ndërkombëtare. Si rrjedhojë, zbatimi i rekomandimeve është bërë një fushë me interes si për aktorët kombëtarë, ashtu edhe ata ndërkombëtarë. ODIHR-i u është përgjigjur kërkesave të shteteve pjesëmarrëse për mbështetje sa i takon shqyrtimit të rekomandimeve për zgjedhjet përmes një sërë aktiviteteve. Këtu përfshihet ofrimi i analizave ligjore dhe opinioneve të ekspertëve për kornizat ligjore, organizimi i tryezave të rrumbullakëta dhe takimeve të ekspertëve, si dhe ofrimi i këshillimit teknike. Gjithashtu, disa shtete pjesëmarrëse kanë përqaftuar praktikën e mirë të raportimit vullnetar mbi ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve për zgjedhjet në Këshillin e Përhershëm të OSBE-së, në Komitetin e Dimensionit Njerëzor dhe në takime dhe aktivitete të tjera. Këto dhe aktivitete të tjera të ngjashme përshkruhen në mënyrë më të hollësishme në Kapitullin 6.

Për mbështetjen e ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve për zgjedhjet janë krijuar edhe mjete të tjera, përveç atyre të OSBE-së. Në nivel global, janë disa mekanizma të Organizatës së Kombeve të Bashkuara që krijojnë një fushë për shqyrtimin e zbatimit të të drejtave politike dhe zgjedhore, siç parashikohen në instrumentet e të drejtave të njeriut, përfshirë Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut (DUDNJ), të vitit 1948, dhe Paktin Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike (PNDKP), të vitit 1966. Në nivel rajonal, rol të ngjashëm luajnë organet e Këshillit të Evropës, përfshirë edhe Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ), dhe ato të Organizatës së Shteteve Amerikane (OSHA), përfshirë edhe Gjykatën Ndër-Amerikane për të Drejtat e Njeriut. Po kështu, edhe Bashkimi Evropian ka hartuar një sërë politikash dhe ka zhvilluar një sërë aktiviteteve me qëllim nxitjen e ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve për zgjedhjet, si brenda, ashtu edhe jashtë shteteve anëtare të BE-së. Edhe traktatet dhe dokumentet e Komonuelthit të Shteteve të Pavarura (KSHP) parashikojnë mekanizma për shqyrtimin e rekomandimeve për zgjedhjet.

2.3 Sfidat në zbatimin e rekomandimeve për zgjedhjet

Shqyrtimi i rekomandimeve për zgjedhjet është një proces i ndërlikuar dhe kërkon përfshirjen e një sërë aktorëve. Këtu mund të përfshihen zyrat ekzekutive të qeverisë për hartimin e politikave kombëtare, parlamentet për hartimin e legjislacionit dhe organet e administrimit të zgjedhjeve (OAZ-të), agjencitë e tjera shtetërore për shtjellimin e procedurave administrative, si dhe aktorët joshitetërorë, si: partitë politike, media dhe OSHC-të, për rishikimin e politikave të brendshme dhe për mbështetjen dhe monitorimin e reformave më të gjera. Megjithatë angazhimet e OSBE-së dhe detyrimet e standardet e tjera ndërkombëtare ofrojnë një kuadër për zgjedhje demokratike, konteksti dhe dinamikat kombëtare bëjnë që çdo situatë zgjedhore të jetë e ndryshme.

Sa i përket pyetjes se pse disa shtete anëtare nuk kanë vullnetin apo nuk janë në gjendje të ndjekin zbatimin e rekomandimeve për zgjedhjet, mund të identifikohen një sërë arsyesh. Këtu përfshihen:

- Mungesa e vullnetit politik, sidomos kur qeveritë apo politikanët në pushtet u rezistojnë ndryshimeve që mund të cenonin pozitën e tyre politike apo aksesin e tyre në pushtet;
- Mungesa e mbështetjes në parlament, sidomos kur reforma zgjedhore shihet si politikisht përçarëse apo si një reformë që kërkon ndryshim të aspekteve themelore të Kushtetutës;
- Mungesa e ekspertizës profesionale për shqyrtimin e rekomandimeve;
- Mungesa e burimeve financiare për zbatimin e reformave që kërkojnë ndryshime të konsiderueshme infrastrukturore;
- Mungesa e kohës deri në zgjedhjet e radhës apo në rastet kur shpallen zgjedhje të parakohshme;
- Shpërthimi i luftës, mungesa e stabilitetit apo trazirash civile; dhe
- Konsiderimi nga homologët vendas i rekomandimeve si jo bindëse, pa objektiva të mjaftueshme dhe të papërshtatshme për kontekstin vendas.

Edhe aktorët ndërkombëtarë mund të përjetojnë sfida në punën e tyre për të ndihmuar në ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve për zgjedhjet, sidomos në çështje, ku shteteve u lihet hapësirë e madhe vendimmarrjeje sa i përket përmbushjes së detyrimeve dhe angazhimeve ndërkombëtare. Aktorët ndërkombëtarë mund t'u mëshojnë detyrimeve, angazhimeve dhe standardeve që duhet të përmbushen; të identifikojnë mangësitë apo paqartësitë sa i përket respektimit të tyre; dhe të ofrojnë asistencë në fuqizimin e zbatimit të tyre. Megjithatë, në fund të fundit, përgjegjësia për trajtimin e këtyre çështjeve i takon shtetit dhe reforma kërkon një sens të fortë autorësie të vetë shtetit. Ofrimi i mbështetjes ndërkombëtare mund të pengohet edhe kur në vend ka rezistencë politike, amulli institucionale, shoqëri civile të dobët apo mungesë të medias së pavarur.

2.4 Ku, çfarë dhe kur duhet të ndiqet zbatimi i rekomandimeve

ODIHR-i vëzhgon vetëm zgjedhjet që mbahen në shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së.³ Si të tilla, aktivitetet për vëzhgimin e zgjedhjeve kufizohen përgjithësisht brenda rajonit të OSBE-së, ndonëse disa aktivitete mund të ndërmerren edhe në disa shtete Partnere për Bashkëpunim të OSBE-së. ODIHR-i ofron mbështetje për zbatimin e rekomandimeve vetëm me kërkesë

³ Përveçse kur, në rrethana përjashtimore, ODIHR-it i jepet një mandat i posaçëm nga Këshilli i Përhershëm i OSBE-së.

të posaçme të shtetit pjesëmarrës në fjalë. Në prag të zgjedhjeve apo gjatë periudhës zgjedhore, ODIHR-i nuk zhvillon aktivitete për zbatimin e rekomandimeve, pasi kjo mund të shihet si kompromentim i aftësisë së tij për të ofruar një vlerësim të pavarur dhe të paanshëm të zgjedhjeve.

Ndjekja e zbatimit të rekomandimeve bazohet në gjetjet dhe rekomandimet e raporteve përfundimtare të ODIHR-it për vëzhgimin e zgjedhjeve. Siç u parashtrua në Kapitullin 4, raportet përfundimtare tregojnë se disa rekomandime kanë përparësi dhe se duhet të trajtohen si elementi thelbësor i çdo procesi për zbatimin e tyre. Vëmendja e duhur duhet t'u kushtohet edhe rekomandimeve, të cilat shihen me përparësi nga shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së, me qëllim pasjen e një qasjeje gjithëpërfshirëse dhe autorësinë e vetë shtetit.

Çdo vit, ODIHR-i zhvillon aktivitete të shumta të vëzhgimit të zgjedhjeve, por nuk ka domosdoshmërisht burimet e nevojshme njerëzore dhe financiare që të ndërmarrë aktivitete në ndihmë të zbatimit të rekomandimeve të tij, pas çdo misioni të tij. Për këtë, nevojitet një shpërndarje e kujdeshme e burimeve për të rritur në maksimum efektshmërinë e aktiviteteve të tilla. Në këtë këndvështrim, treguesit e mëposhtëm përbëjnë bazën e përcaktimit të përparësive të angazhimit, në mbështetje të zbatimit të rekomandimeve të tij.

1. **Interesi i autoriteteve.** Këtu përfshihet pranimi i nevojës për përmirësimin e zhvillimit të zgjedhjeve, si dhe ndërmarrja e hapave fillestare, si për shembull mbajtja e një dialogu publik për reformën, hartimi i planeve për zbatimin e rekomandimeve dhe kërkesa zyrtare drejtuar ODIHR-it për asistencë.
2. **Shkalla e nevojës.** Kjo mund të vlerësohet në bazë të gjetjeve dhe rekomandimeve të ODIHR-it, në raportet e veta përfundimtare për zgjedhje të mëparshme. Këtu mund të merret në konsideratë edhe rreziku i mosmarrëveshjeve në lidhje me zgjedhjet apo dhunës në zgjedhjet e ardhshme.
3. **Koha në dispozicion.** Mbajtja e konsultimeve të gjera me palët e interesuara në zgjedhje, rishikimi dhe miratimi i legjislacionit, përcaktimi i procedurave dhe zbatimi i programeve për trajnimin dhe informimin e zgjedhësve kërkojnë kohë. Nëse deri në zgjedhjet e radhës nuk mbetet shumë kohë, mund të bëhet rishikimi i rekomandimeve për të identifikuar rreziqet e mundshme nga ndërmarrja e hapave përmirësuese në një kohë të shkurtër dhe për të rishikuar aktivitetet që kanë përparësi.
4. **Aktivitetet plotësuese.** Vëmendje u duhet kushtuar aktiviteteve për zbatimin e rekomandimeve, që ndërmarrin organizatat vendase dhe ato ndërkombëtare, dhe se si mund t'i plotësojë ODIHR-i këto aktivitete në

mënyrë të tillë që të mos ketë përsëritje dhe mangësi, ndërsa i shtohet vlerë këtij procesi.

Këta tregues për përcaktimin e përparësive mes aktiviteteve për zbatimin e rekomandimeve mund të përdoren edhe për rishikimin periodik të vlerës së aktiviteteve të vazhdueshme të procesit të zbatimit, përfshirë edhe nevojën e një rikalibrimi të mundshëm. Kjo mund të jetë veçanërisht e rëndësishme nëse ekziston një risk i identifikuar për mosmarrëveshje të rënda lidhur me zgjedhjet apo me akte dhune që mund të ndodhin.

ISTANBUL 1999 (Charter for European Security, par. 25)

25. We reaffirm our obligation to conduct free and fair elections in accordance with OSCE commitments, in particular the Copenhagen Document 1990. We recognize the assistance the ODIHR can provide to participating States in developing and implementing electoral legislation. In line with these commitments, we will invite observers to our elections from other participating States. The ODIHR, the OSCE Parliamentary Assembly and appropriate institutions and organizations that wish to observe our election proceedings. We agree to follow up promptly the ODIHR's election assessment and recommendations.

3. Angazhimet e OSBE-së dhe detyrimet e standardet e tjera ndërkombëtare për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve për zgjedhjet

Detyrimi për mbajtjen e zgjedhjeve të vërteta, që pasqyrojnë shprehjen e lirë të vullnetit të popullit, është një detyrim i mirëkonsoliduar, siç reflektohet në nenin 21 të DUDNJ-së dhe në nenin 25 të PNDCP-së. Në Dokumentin e Kopenhagenit të OSBE-së, të vitit 1990, të gjitha shtetet pjesëmarrëse ranë dakord që "vullneti i popullit, i shprehur lirisht dhe në mënyrë të ndershme përmes zgjedhjeve të vërteta dhe periodike, është baza e autoritetit dhe legjitimitetit të të gjithë shtetit".

Dokumenti i Kopenhagenit të OSBE-së, PNDCP-ja dhe instrumente të tjera ndërkombëtare për të drejtat e njeriut e bëjnë të qartë se shtetet duhet të ndërmarrin hapat e nevojshme për t'i zbatuar këto të drejta. Kjo përfshin

garantimin e përfshirjes në kuadrin ligjor të detyrimeve dhe angazhimeve ndërkombëtare për të cilat shtetet kanë rënë dakord, si dhe garantimin e respektimit të tyre në praktikë. Ndonëse shtetet gëzojnë një liri veprimi të një shkalle të madhe sa i takon zbatimit të këtyre detyrimeve dhe angazhimeve, rekomandimet e aktiviteteve të ODIHR-it për vëzhgimin e zgjedhjeve dhe të organeve të tjera të të drejtave të njeriut mund të ofrojnë një orientim bindës në përafrimin e legjislacionit dhe praktikës, sa më afër detyrimeve dhe angazhimeve zgjedhore.

Është e rëndësishme të vihet në dukje se ka një sërë dokumentesh të OSBE-së, që nxisin respektimin nga ana e shteteve pjesëmarrëse të instrumenteve universale – si dhe rajonale – të të drejtave të njeriut. Për shembull, Akti Final i Helsinkit, i vitit 1975, i angazhon shtetet që të “veprojnë në përputhje me DUDNJ-në” dhe të “përbushin detyrimet e tyre, të parashikuara në deklaratat dhe marrëveshjet ndërkombëtare në këtë fushë, përfshirë mes të tjerash dhe Paktet Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut, të cilat ato janë të detyruara t’i zbatojnë”. Dokumenti i Madridit, i vitit 1983, u bënte thirrje shprehimisht “atyre shteteve pjesëmarrëse që nuk e kanë bërë ende këtë gjë, të shohin mundësinë e aderimit në këto pakte”. Dokumente të mëvonshme të OSBE-së ritheksojnë rëndësinë e aderimit në traktate ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, protokollat fakultative përkatëse dhe në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ), të vitit 1950.⁴ Shtetet pjesëmarrëse kanë pranuar, gjithashtu, se përbushja e angazhimeve, përfshirë edhe ato që lidhen me zgjedhjet, nuk është çështje e brendshme, por duhet konsideruar si çështje me interes ndërkombëtar. Në Dokumentin e Moskës, të vitit 1991, shtetet pjesëmarrëse deklaruan “në mënyrë kategorike dhe të përvokueshme” se: “angazhimet e ndërmarra në fushën e dimensionit njerëzor të OSBE-së janë çështje me interes të drejtpërdrejtë dhe legjitim për të gjitha shtetet pjesëmarrëse dhe nuk u përkasin çështjeve të brendshme të shteteve përkatëse”. Në Samitin e Astanës, të vitit 2010, shtetet pjesëmarrëse rikonfirmuan “respektimin e plotë” të një sërë instrumentesh të OSBE-së dhe instrumentesh universale, si dhe “përgjegjësinë e tyre për zbatimin e tyre të plotë dhe në mirëbesim”.

3.1 Angazhimet e OSBE-së

ODIHR-i është institucioni kryesor në OSBE, i ngarkuar me mandatin e ndjekjes së programeve dhe aktiviteteve në procesin e zbatimit të rekomandimeve për

4 Shih, gjithashtu, paragrafin 13.2 të Dokumentit të Vjenës, të vitit 1989, mbi aderimin në përgjithësi në traktate ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, paragrafin 15 të Konventës për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave, si dhe paragrafin 40.2 të Dokumentit të Moskës, të vitit 1991, mbi të njëjtën Konventë. Paragrafi 5.20 dhe 5.21 i Dokumentit të Kopenhagenit, të vitit 1990, i referohen aderimit në këto traktate për të drejtat e njeriut në përgjithësi, përfshirë edhe KEDNJ-në. Paragrafi 32, Kapitulli VI i Dokumentit të Helsinkit, të vitit 1992, i referohet aderimit në Konventën Ndërkombëtare për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racial.

zgjedhjet. Karta e Parisit, e vitit 1990, krijoi ODIHR-in (i quajtur atëherë Zyra për Zgjedhje të Lira) me mandatin për "përmirësimin e zbatimit" të angazhimeve që lidheshin me zgjedhjet, veçanërisht të atyre të Dokumentit të Kopenhagenit i OSBE-së, të vitit 1990.

Shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së janë angazhuar në mënyrë të shpeshtë dhe të shprehur për zbatimin e rekomandimeve të ODIHR-it për zgjedhjet. Rëndësia e zbatimit të rekomandimeve për zgjedhjet është theksuar nga krerët e shteteve pjesëmarrëse në Samitin e Stambollit, të vitit 1999, ku ata ranë dakord të "ndjekin menjëherë vlerësimin dhe rekomandimet që bën ODIHR-i për zgjedhjet" dhe të njohin "asistencën që ODIHR-i mund t'u japë shteteve pjesëmarrëse në hartimin dhe zbatimin e legjisllacionit për zgjedhjet". Kjo erdhi pas/ një shtojce në Dokumentin e Këshillit Ministror të Oslos, të vitit 1998, ku shtetet pjesëmarrëse nxiteshin të "zbatojnë në mënyrë të menjëhershme rekomandimet e bëra nga ODIHR-i pas zgjedhjeve". Në të theksohet, gjithashtu, se "ODIHR-i duhet t'i ofrojë shtetit të interesuar asistencë në zbatimin e atyre rekomandimeve dhe duhet të raportojë në Këshillin e Përhershëm mbi ecurinë e zbatimit të tyre".

Angazhimi për zbatimin e rekomandimeve për zgjedhjet është përsëritur edhe në disa vendime të mëvonshme të Këshillit Ministror të OSBE-së. Në Takimin e Portos, të vitit 2002, shtetet pjesëmarrëse njohën "ekspertizën e ODIHR-it në ndihmesën që u jep shteteve pjesëmarrëse për zbatimin e angazhimeve që lidhen me zgjedhjet" dhe ranë dakord "të reagojnë me vendosmëri më të madhe ndaj rekomandimeve të ODIHR-it". Në Takimin e Mastrihtit, të vitit 2003, shtetet pjesëmarrëse ranë dakord të "informojnë Këshillin e Përhershëm të OSBE-së mbi ecurinë e arritur në përbushjen e kësaj detyre". Në Takimin e Brukselit, të vitit 2006, shtetet pjesëmarrëse theksuan se "ishin përgjegjëse për zbatimin e efektshëm të angazhimeve të tyre të ndërmarra në OSBE" dhe se ODIHR-i "luan një rol të rëndësishëm në ndihmesën që u jep atyre", përfshirë edhe "rishikimin e legjisllacionit për zgjedhjet". Takimi në Bruksel pasoi një raport të Panelit të Personave të Shquar të vitit 2005, ku u theksua se shtetet pjesëmarrëse dhe ODIHR-i duhet "t'i kushtojnë më shumë vëmendje zbatimit të rekomandimeve pas zgjedhjeve përmes dialogut dhe mbështetjes praktike për bashkëpunim" dhe se "pas konsultimeve me shtetin përkatës, ODIHR-i duhet të raportojë në Këshillin e Përhershëm mbi zbatimin e rekomandimeve për zgjedhjet".

Janë gjithashtu një sërë angazhimesh që ofrojnë orientim specifik për shtetet pjesëmarrëse në proceset e tyre të zbatimit të rekomandimeve për zgjedhjet. Për shembull, paragrafët 5.7, 5.8 dhe 7.1 të Dokumentit të Kopenhagenit të OSBE-së, të vitit 1990, i angazhojnë shtetet pjesëmarrëse t'i garantojnë me ligj të drejtat zgjedhore, ligj i cili duhet të miratohet pas një procedure

publike, dhe se ato ligje duhet të jenë të aksesueshme për të gjithë. Sa i përket procesit gjithëpërfshirës, paragrafi 18.1 i Dokumentit të Moskës, të vitit 1991, konfirmon se legjislati duhet të formulohet dhe të miratohet si rrjedhojë e një procesi të hapur, që pasqyron vullnetin e popullit. Po kështu, paragrafi 27 i Dokumentit të Stambollit, të vitit 1999, thekson rolin e rëndësishëm të organizatave joqeveritare në garantimin e përmbushjes së të drejtave të njeriut dhe lirive themelore. Të marra të gjitha së bashku, këto dokumente angazhojnë shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së që të zbatojnë rekomandimet e ODIHR-it për zgjedhje dhe konfirmojnë rolin e rëndësishëm, që mund të luajë ODIHR-i në mbështetjen e procesit të zbatimit.

3.2 Instrumentet universale

OKB-ja ofron një kuadër global që mund të udhëheqë zbatimin e rekomandimeve për zgjedhjet dhe të ndihmojë shtetet që të përmirësojnë kryerjen e zgjedhjeve të tyre. Në zbatimin e mandatit të saj për të ruajtur paqen dhe sigurinë, OKB-ja e ka njohur vazhdimisht rëndësinë e zgjedhjeve të besueshme demokratike. Nga 57 shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së, 56 janë shtete anëtare të OKB-së dhe njëri prej tyre është vëzhgues i përhershëm.

Sistemi i OKB-së bën dallimin midis instrumenteve për të drejtat e njeriut, të bazuara tek traktatet, dhe atyre të bazuara në Kartën e Kombeve të Bashkuara. Traktatet e OKB-së krijojnë pjesën më të madhe të detyrimeve universale, që kanë të bëjnë me zgjedhjet. Traktati kryesor i të drejtave të njeriut, që lidhet me zgjedhjet, është Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike. Në kuadrin e të drejtës për të marrë pjesë në jetën politike dhe publike në kuptimin më të gjerë, ky Pakt përfshin detyrimet ndaj të drejtës për t'u zgjedhur dhe për të zgjedhur, ndaj lirive themelore dhe ndaj të drejtës për mjete juridike të efektshme. Traktatet e tjera ofrojnë mbrojtje më të madhe të të drejtave zgjedhore për grupe të caktuara ose i zgjerojnë të drejtat duke trajtuar çështje të tjera tematike. Traktatet që kanë të bëjnë me të drejtat e njeriut përfshijnë Konventën Ndërkombëtare për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racial (KNEDR), e vitit 1965, e cila u referohet të drejtave zgjedhore pa dallim ose diskriminim, dhe Konventën mbi Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (KEDNG), e vitit 1979, e cila përfshin detyrimet për pjesëmarrjen politike të grave. Konventa Ndërkombëtare për Mbrojtjen e të Drejtave të të Gjithë Punëtorëve Migrantë dhe Anëtarëve të Familjeve të Tyre (KNPM), e vitit 1990, mbron të drejtat zgjedhore të migrantëve dhe familjeve të tyre dhe Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (KDKPAK), e vitit 2006, parashikon të drejtat të qarta për pjesëmarrjen politike të personave me aftësi të kufizuara. Përveç kësaj, Konventa kundër Korrupsionit (KKBKK), e

vitet 2003, përmban dispozita për transparencën e organeve të administratës publike dhe të financimit të fushatave zgjedhore.

Për informacione të përditësuara rreth ratifikimit dhe nënshkrimit të instrumenteve të sistemit të OKB-së nga shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së, vizitoni bazën e të dhënave të Përmbledhjes së Traktateve të OKB-së në: <<https://treaties.un.org/>>.

Secili prej këtyre traktateve krijon një organ të përbërë nga ekspertë të pavarur, për të monitoruar përmbushjen e detyrimeve nga ana e shteteve që i kanë ratifikuar apo kanë aderuar në to. Për shembull, në rastin e PNDCP-së, ky organ është Komiteti i të Drejtave të Njeriut (KDCP)⁵ Traktatet i detyrojnë shtetet palë të respektojnë autoritetin e organit përkatës të monitorimit të traktatit. Organe të tilla, zakonisht, nxjerrin interpretime zyrtare ("komente të përgjithshme" ose "rekomandime të përgjithshme"), të cilat shtjellojnë imtësisht detyrimet e traktatit. Veçanërisht, Komenti i Përgjithshëm nr. 25 i KDCP-së pohon se e drejta për të marrë pjesë në çështjet publike duhet të përfshijë mundësinë për të kontribuar në hartimin dhe zbatimin e politikave në nivel ndërkombëtar, kombëtar dhe vendor. Organet e monitorimit të traktateve shqyrtojnë edhe raportet periodike të shteteve palë, mbi masat e miratuara për të zbatuar të drejtat e traktatit në formën e "Vëzhgimeve përmblylëse", të cilat, kryesisht, u japin rekomandime shteteve se si të garantojnë gëzimin e këtyre të drejtave. Për shkallën në të cilën janë trajtuar këto rekomandime duhet të raportohen nga shteti, në raportin periodik të radhës. Vëzhgime përmblylëse janë nxjerrë për të gjitha shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së, shpesh nga disa organe të monitorimit të traktateve.

Disa shtete kanë ratifikuar ose aderuar në protokolle fakultative shtesë të traktate të caktuara, të cilat i japin organit përkatës të traktatit autoritetin për t'u marrë me komunikimet nga individë, të cilët pretendojnë të jenë viktima të shkeljes së traktatit, pas shterimit të mjeteve të juridike vendase. Vendimet për ankimet individuale përbëjnë interpretime zyrtare të traktatit në fjalë. Shtetet palë janë zotuar të respektojnë gjetjet e organeve të traktateve, të cilët, nga ana tjetër, kanë zhvilluar procedura ndjekjeje për të kontrolluar zbatimin e rekomandimeve të tyre nga ana e shteteve. Pasi konstatohet shkelja, zakonisht, shtetit i lihen gjashtë muaj për të dhënë informacion mbi hapat e ndërmarrë për ta zgjidhur atë. Nëse shteti nuk arrin të ndërmarrë veprimet e duhura, çështja mbetet e hapur dhe ndiqet një dialog formal derisa të arrihet një rezultat i kënaqshëm.

5 Organet e tjera të traktateve janë përkatësisht: Komiteti për Eliminimin e Diskriminimit Racial (KEDR); Komiteti për Eliminimin e Diskriminimit ndaj Grave (Komiteti KEDNG); Komiteti për Punëtorët Migrantë (KPM); Komiteti për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (Komiteti KDPAK). Në dallim nga të tjerat, KKBKK krijon Konferencën të Shteteve Palë për të përmirësuar bashkëpunimin dhe për të nxitur zbatimin e traktatit.

Edhe një sërë organesh të krijuara sipas Kartës së Kombeve të Bashkuara mund të luajnë rol në zbatimin e rekomandimeve për zgjedhjet. Këtu përfshihen Këshilli i Sigurimit dhe Asambleja e Përgjithshme, rezolutat e të cilave mund t'u referohen drejtpërdrejt zgjedhjeve në një vend të caktuar ose një teme të veçantë. Për shembull, Asambleja e Përgjithshme nxjerr një rezolutë të përhershme, çdo dy vjet, për të rritur vëmendjen ndaj parimeve zgjedhore. Në vitin 2013, për herë të parë, dhe përsëri në vitin 2015, rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme pohoi se shtetet anëtare të OKB-së kanë detyrimin të marrin të gjitha masat e duhura për t'i garantuar çdo shtetasi të drejtën dhe mundësinë reale për të marrë pjesë në zgjedhje në mënyrë të barabartë. Në vitin 1998, Asambleja e Përgjithshme lëshoi një deklaratë mbi të drejtat dhe përgjegjësitë, ku pohohej se kushdo ka të drejtën për të paraqitur kritika dhe propozime për përmirësimin e funksionimit të organeve, agjencive dhe organizatave qeveritare. Procedurat e veçanta të OKB-së - përfshirë Raportuesit Specialë, ekspertët e pavarur dhe grupet e punës - mund t'i referohen edhe reformës zgjedhore, në kuadër të raporteve dhe aktiviteteve të tyre të përgjithshme.

Përveç kësaj, mekanizmi i Rishikimit Periodik Universal (RPU) ofron një mundësi për të gjitha shtetet anëtare të OKB-së që të deklarojnë veprimet e ndërmarra për të përmirësuar situatën e tyre të të drejtave të njeriut dhe përmbushjen e detyrimeve ndaj të drejtave të njeriut, përfshirë dhe ato që lidhen me zgjedhjet. Në përfundim të RPU-së, nxirret një raport përfundimtar, ku përfshihen rekomandime për të trajtuar shkeljet. Në kuadër të RPU-ve pasuese, shtetet duhet të shpjegojnë se si i kanë zbatuar rekomandimet. Çdo shtet merret në shqyrtim çdo 4.5 vjet dhe ODIHR-i ndan rregullisht dhe sistematikisht raportet e tij për zgjedhjet me mekanizmin e RPU-së. Të gjitha shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së kanë marrë pjesë në RPU I marrë në tërësi, ky kuadër global përcakton detyrimet që lidhen me zgjedhjet dhe mekanizmat për të nxitur përmbushjen e tyre. Raportet për vëzhgimin e zgjedhjeve kontribuojnë në këtë proces duke identifikuar mangësitë dhe duke dhënë rekomandime se si të përmirësohet përmbushja e detyrimeve. Nga ana tjetër, edhe ndjekja e rekomandimeve për zgjedhjet mund të ndihmojë në nxitjen e pajtueshmërisë me traktatin.

3.3 Instrumente të tjera rajonale

Këshilli i Evropës luan rol kyç në forcimin e respektimit të të drejtave të njeriut në të 47 shtetet anëtare të tij, të cilat janë të gjitha shtete pjesëmarrëse të OSBE-së. Neni 3 i Protokollit të Parë të KEDNJ-së i detyron shtetet e Këshillit të Evropës "të zhvillojnë zgjedhje të lira, me votim të fshehtë, në intervale të arsyeshme, në kushte që garantojnë shprehjen e lirë të mendimit të popullit në zgjedhjen e legjislaturës". GJEDNJ-ja ka për detyrë të sigurojë respektimin e KEDNJ-së. Pasi janë shteruar mjetet e ligjshme juridike të brendshme, çdo

person, organizatë joqeveritare ose grup individësh, që pretendojnë të jenë viktimë e shkeljes së të drejtave të përcaktuara në KEDNJ, përfshirë edhe çështjet zgjedhore, mund të ngrenë padi në gjykatë kundër një shteti palë. Në vitet e fundit, GJEDNJ-ja ka marrë në shqyrtim padi të lidhura me zgjedhjet për një gamë të gjerë çështjesh, përfshirë dhe të drejtën e votimit të të burgosurve, të personave me aftësi të kufizuara mendore dhe shtetasve jorezidentë; rregullat dhe vendimet për përmbushjen e kriterëve nga ana e kandidatëve; parregullsitë e votimit; përcaktimin e sistemit zgjedhor; përbërjen dhe paanshmërinë e organeve të administrimit të zgjedhjeve; procesin e rregullt në procedurat e ankimit dhe apelimit, si dhe mbulimin mediatik të zgjedhjeve. GJEDNJ-ja në vendimet dhe gjykimet e saj iu është referuar gjithmonë e më shumë raporteve të vëzhgimit të zgjedhjeve të ODIHR-it. Vendimet e formës së prerë të gjykatës janë të detyrueshme për shtetet në fjalë dhe janë tregues për shtetet e tjera anëtare të Këshillit të Evropës. Komiteti i Ministrave i Këshillit të Evropës mbikëqyr ekzekutimin e vendimeve gjyqësore përmes procesit politik të presionit të grupit përkatës.

Komisioni Evropian për Demokraci përmes Ligjit (Komisioni i Venecias) është një organ këshillimor i Këshillit të Evropës. Ky Komision ka 60 shtete anëtare, 51 nga të cilat janë shtete pjesëmarrëse të OSBE-së. Komisioni i Venecias nxjerr raporte dhe jep rekomandime për një sërë çështjesh ligjore, përfshirë dhe zgjedhjet e referendumet, dhe monitoron zbatimin e tyre në seancat plenare tremujore të tij. Në vitin 2002, Komisioni i Venecias publikoi Kodin e Praktikës së Mirë në Çështjet Zgjedhore si një dokument referimi për Këshillin. Në mënyrë që të garantohet qëndrueshmëria e ligjit, Kodi rekomandon që elementet themelore të ligjit zgjedhor, në parim, nuk duhet të jenë të hapura për ndryshime në vitin para zgjedhjeve. Një zgjidhje tjetër mund të jetë përcaktimi se, nëse ndryshohen elementet themelore të ligjit zgjedhor, për zgjedhjet e ardhshme do të zbatohet sistemi i mëparshëm - të paktën nëse zhvillohen brenda vitit të ardhshëm - dhe se sistemi i ri do të hyjë në fuqi pas kësaj. Megjithatë, zbatimi i rekomandimeve konsiderohet si përjashtim nga parimi i qëndrueshmërisë së legjislacionit për zgjedhjet, i cili "nuk duhet përdorur për të mbajtur një situatë në kundërshtim me standardet e trashëgimisë zgjedhore evropiane, ose për të penguar zbatimin e rekomandimeve të organizatave ndërkombëtare".⁶

Grupi i Shteteve të Këshillit të Evropës kundër Korrupsionit (GRECO) nxjerr raporte që përfshijnë rekomandime në lidhje me financimin e partive politike dhe fushatave. Grupi ka 49 anëtarë, të gjitha shtete pjesëmarrëse të OSBE-së. Megjithatë rekomandimet e Komisionit të Venecias dhe të GRECO-s nuk janë ligjërish të detyrueshme, ato mund të nxjerrin udhëzues që gëzojnë autoritet

6 Seksioni II.2 i Deklaratës interpretuese të Komisionit të Venecias për qëndrueshmërinë e ligjit zgjedhor. Shih Shtojcën A.

të plotë për shtetet pjesëmarrëse që janë anëtare të këtyre organizmave. BE-ja është angazhuar për nxitjen dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe demokracisë, si brenda kufijve të saj, ashtu edhe në marrëdhëniet me vendet joanëtare të BE-së. BE-ja ka 28 shtete anëtare, të gjitha janë shtete pjesëmarrëse të OSBE-së. Në dokumentet e saj politike BE-ja ka theksuar rëndësinë e zbatimit të rekomandimeve për zgjedhjet. Në vitin 2012, BE-ja miratoi Kornizën Strategjike dhe Planin e Veprimit për të Drejtat e Njeriut dhe Demokracinë, ku përcaktohet se institucionet e saj kanë përgjegjësinë për të "futur në sistem vijimësinë e misioneve të vëzhgimit të zgjedhjeve të BE-së dhe të raporteve e tyre, në mbështetje të të gjithë ciklit zgjedhor dhe për të siguruar zbatimin e efektshëm të rekomandimeve të tyre dhe të raporteve të organizmave të tjera të vëzhgimit të zgjedhjeve (p.sh.: OSBE/ODIHR)". Në vitin 2015, u miratua një Plan i ri Veprimi për të Drejtat e Njeriut dhe Demokracinë, ku u theksua nevoja për "konsolidimin e praktikave më të mira për shfrytëzimin sa më të mirë të MVZ-ve të BE-së dhe rekomandimeve të misioneve të vëzhgimit të zgjedhjeve të OSBE/ODIHR-it në BE dhe aktiviteteve të shteteve anëtare të BE-së, në mbështetje të dialogëve politikë dhe demokracisë," për të rritur në maksimum ndikimin e vëzhgimit të zgjedhjeve.

KSHP-ja ka njohur edhe vlerën e procesit të ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve për zgjedhjet. KSHP-ja ka 11 shtete anëtare, të gjitha janë shtete pjesëmarrëse të OSBE-së. Deklarata për Parimet e Vëzhgimit Ndërkombëtar të Zgjedhjeve dhe Referendumeve, e Asamblesë Ndër-parlamentare të Shteteve të KSHP-së, e vitit 2008, nxjerr në pah një sërë etapash të rëndësishme për zbatimin e rekomandimeve. Këtu përfshihet nxjerrja e një raporti përfundimtar, ku përfshihen rekomandime teknike, të cilat duhet t'i paraqiten institucioneve të KSHP-së, jo më vonë se dy muaj pas datës së zgjedhjeve OSHA-ja nxit zgjedhjet demokratike në të gjithë Amerikën. OSHA-ja ka 35 shtete anëtare, dy prej të cilave janë shtete pjesëmarrëse të OSBE-së. Karta Demokratike Ndër-amerikane (KDNA), e miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e OSHA-së në vitin 2001, i jep mandat organizatës të kryejë aktivitete të vëzhgimit të zgjedhjeve dhe të japë ndihmë për zgjedhjet me kërkesë të shteteve anëtare. KDNA-ja kërkon misioneve vëzhguese të zgjedhjeve që të paraqesin raportin e tyre para Këshillit të Përhershëm të OSHA-së. Rekomandimet e secilit raport përbëjnë bazën për mbështetjen paszgjedhore nga OSHA-ja, mbështetje që mund të përfshijë asistencë ligjore dhe teknike.

3.4 Standarde të tjera për zbatimin e rekomandimeve

Standardet profesionale për vëzhguesit ndërkombëtarë të zgjedhjeve janë përcaktuar në Deklaratën e Parimeve për Vëzhgimin Ndërkombëtar të Zgjedhjeve (DP), janë përhëndetur në Kombet e Bashkuara, në vitin 2005,

dhe janë mbështetur nga më shumë se 50 organizata që kryejnë vëzhgimin e zgjedhjeve në mbarë botën. ODIHR-i ishte një nga 23 organizatat e para që mbështetën DP-në. Në lidhje me zbatimin, në DP thuhet se misionet e vëzhgimit "duhet të... [paraqesin] gjetjet, përfundimet e tyre dhe çdo rekomandim të përshtatshëm, që përcaktojnë se mund të ndihmojë në përmirësimin e proceseve që kanë të bëjnë me zgjedhjet". Ka një referencë edhe për aktivitetet e mundshme të zbatimit, duke pranuar se misionet vëzhguese "mund të kryejnë edhe takime private me palët organizuese të zgjedhjeve të vërteta demokratike në një vend, për të diskutuar gjetjet, përfundimet dhe rekomandimet e misionit". Në DP nënvizohet edhe nevoja për bashkëpunim në aktivitetet vijuese zbatuese, duke iu kërkuar organizatave mbështetëse që "në çdo rrethanë" të "punojnë së bashku për të pasur kontribut maksimal në misionet e tyre ndërkombëtare të vëzhgimit të zgjedhjeve".

Në vitin 2012, u përcaktuan standarde të barasvlershme për vëzhguesit qytetarë të zgjedhjeve përmes Deklaratës së Parimeve Globale për Vëzhgimin dhe Monitorimin Jopartiak të Zgjedhjeve nga Organizatat e Qytetarëve. Këtu përfshihet angazhimi për të dhënë "rekomandimet e duhura për të pasur zgjedhje të vërteta demokratike" dhe për të mbështetur "përmirësimet në kuadrin ligjor për zgjedhjet, zbatimin e tyre nga administrata zgjedhore dhe heqjen e pengesave për pjesëmarrjen e plotë të shtetasve në proceset zgjedhore dhe politike". Si të tillë, grupet e vëzhguesve qytetarë mund të luajnë rol të rëndësishëm në hartimin e rekomandimeve për zgjedhjet dhe në aktivitetet vijuese. ODIHR-i është mbështetës ndërkombëtar i Deklaratës dhe më shumë se 250 grupe të vëzhguesve qytetarë nga e gjithë bota e kanë mbështetur këtë dokument. Edhe Deklarata e Parisit mbi Efikasitetin e Ndihmës, e vitit 2005, dhe Axhenda e Akras për Veprim, e vitit 2008, janë dokumente informuese për hartimin e veprimtarive zbatuese. Këto marrëveshje, të nënshkruara nga një numër i madh shtetesh pjesëmarrëse të OSBE-së, nxisin një qasje më efektive ndaj ndihmës ndërkombëtare, që përqendrohet në parimet e autorësisë kombëtare, në partneritetet gjithëpërfshirëse midis shtetit dhe partnerëve ndërkombëtarë, në projektet që janë të harmonizuara dhe plotësuese, në ndihmën që zhvillon kapacitetin e homologëve vendas dhe në proceset e orientuara drejt rezultateve që nxisin llogaridhënie.

3.5 Principles for Follow-up

ODIHR-i u kushton një vëmendje të veçantë disa parimeve kryesore, të përshkruara më poshtë, kur mbështet zbatimin e rekomandimeve për zgjedhjet. Disa nga këto parime janë prekur këtu dhe në kapitujt e mëparshëm, ndërsa të tjerët shtjellohen imtësisht, më poshtë, në manual.

- ODIHR-i nxit dhe mbështet zbatimin e rekomandimeve të dhëna nga misionet e vëzhgimit të zgjedhjeve, për të realizuar të drejtat demokratike sipas angazhimeve të marra në marrëveshjet politike dhe në traktatet ligjërish të detyrueshme.
- ODIHR-i ofron mbështetje për zbatimin e rekomandimeve vetëm me kërkesë të shteteve pjesëmarrëse përkatëse.
- ODIHR-i ndërmerr aktivitete zbatuese në mënyrë objektive, të paanshme, neutrale dhe të pavarur, duke pasur parasysh se shtetet pjesëmarrëse kanë përgjegjësinë kryesore për organizimin e zgjedhjeve.
- ODIHR-i i jep përparësi ndihmës për zbatimin e rekomandimeve sipas nevojave dhe interesave të shtetit pjesëmarrës, sipas kohës në dispozicion përpara zgjedhjeve të radhës dhe sipas burimeve që ODIHR-i ka në dispozicion.
- ODIHR-i mbështet praktikën e mirë në reformën zgjedhore, duke punuar sipas ciklit zgjedhor, duke nxitur vullnetin politik, duke mbështetur kapacitetet e qëndrueshme të administratës zgjedhore, duke nxitur konsultimet me publikun dhe përfshirjen e tij, duke iu referuar angazhimeve në kuadrin e OSBE-së dhe detyrimeve e standardeve të tjera ndërkombëtare, duke u bazuar në ekspertizën vendase dhe atë ndërkombëtare, si dhe duke nxitur hartimin e planeve, raportimet publike dhe mekanizmat rishikuese.
- ODIHR-i nxit pluralizmin politik dhe pjesëmarrjen e grupeve të papërfaqësuara sa duhet në proceset e zbatimit, si mjet për të nxitur mundësi të barabarta për pjesëmarrje në zgjedhje.
- ODIHR-i bashkëpunon me të tjera organizata vëzhguese ndërkombëtare dhe me grupet e vëzhguesve qytetarë për të nxitur mbështetjen e bashkërenduar në aktivitetet zbatuese.
- ODIHR-i kryen aktivitete zbatuese në mënyrë transparente dhe të hapur.
- ODIHR-i rishikon rregullisht praktikat e veta zbatuese për të identifikuar përmirësime të mundshme.
- ODIHR-i nxit shtetet pjesëmarrëse të raportojnë për zbatimin e rekomandimeve për zgjedhjet nga ana e tyre, përmes strukturave të OSBE-së, si dhe përmes mekanizmave të tjerë universalë dhe rajonalë.



4. Angazhimi paszgjedhor: qasja sipas ciklit zgjedhor

Qasja sipas ciklit zgjedhor është mënyrë për t'i parë zgjedhjet më shumë si procese të vazhdueshme dhe jo si ngjarje të veçuara. Sipas kësaj qasjeje, zgjedhjet konsistojnë në një numër përbërësish të ndërlidhur, që ndërveprojnë dhe ndikojnë tek njëri-tjetri, duke filluar disa vite para zgjedhjeve dhe duke përfunduar shumë kohë ditës së zgjedhjeve. Cikli zgjedhor nuk ka pika fillestare ose përfundimtare, por mund të ndahet përgjithësisht në tri periudha kryesore: në atë parazgjedhore, zgjedhore dhe paszgjedhore.⁷

ODIHR-i është i hapur për dialog rreth zbatimit të rekomandimeve gjatë gjithë ciklit zgjedhor. Aktivitetet që i përkushtohen zbatimit kufizohen në periudhën paszgjedhore. Angazhimi paszgjedhor ka tre elemente kyçe: (1) botimin e raportit përfundimtar të ODIHR-it; (2) paraqitjen e raportit përfundimtar; dhe (3) aktivitetet zbatuese.

⁷ Shih diagramin e ciklit zgjedhor të Institutit Ndërkombëtar për Demokraci dhe Asistencë Zgjedhore në: <<http://www.idea.int/elections/eea/>>.




Figura 1: Cikli i vëzhgimit të zgjedhjeve

Në një fazë të mëvonshme, misionet e vlerësimit të nevojave parazgjedhore të ODIHR-it (MVN-të) janë një mundësi për të vlerësuar shkallën, në të cilën janë zbatuar rekomandimet e mëparshme.

4.1 Publikimi i raportit përfundimtar

Guri i themelit të zbatimit të efektshëm të rekomandimeve gjendet në raportet e vëzhgimit të zgjedhjeve të ODIHR-it. Raporti përfundimtar i aktivitetit të ODIHR-it për vëzhgimin e zgjedhjeve nxirret rreth dy muaj pas përfundimit të procesit zgjedhor. Raporti i dërgohet shtetit pjesëmarrës, publikohet në faqen zyrtare në internet të ODIHR-it dhe qarkullohet tek bashkëbiseduesit brenda vendit, tek mjetet e informacionit të publikut, shtetet e tjera pjesëmarrëse, organizatat ndërkombëtare dhe anëtarët e komunitetit akademik. Raporti përkthehet në gjuhët zyrtare të shtetit pjesëmarrës.

Një element kyç i raportit janë rekomandimet e dhëna për të përmirësuar kuadrin dhe kryerjen e zgjedhjeve të ardhshme. Rekomandimet përfshihen që të shqyrtohen nga shteti dhe autoritetet zgjedhore, partitë politike, mediat,

shoqëria civile dhe palët e tjera të interesuara. Rekomandimet nxirren nga vëzhgimet e rasteve ku nuk janë zbatuar ende angazhimet dhe detyrimet, ose ku mund të forcohen praktikat. Disa prej rekomandimeve mund të kërkojnë ndryshime në legjislacionin kryesor, ndërsa të tjera mund të përqendrohen tek praktika zgjedhore. Rekomandimet duhet të jenë konstruktive dhe konkrete, dhe të japin sugjerime të qarta se si mund të zbatohen ndryshimet në përputhje me angazhimet e marra në kuadrin e OSBE-së dhe me detyrimet e standardet e tjera ndërkombëtare. Rekomandimet jepen më shumë për të këshilluar dhe ndihmuar sesa për të drejtuar shtetet pjesëmarrëse. Ato nuk kanë për qëllim të kenë karakter tejet urdhërues dhe ato duhet të lënë liri veprimi për t'iu përshtatur rrethanave të veçanta. Linjat kryesore të rekomandimeve që mund të jepen, duhet të diskutohen me bashkëbiseduesit vendas gjatë misionit të vëzhgimit, për t'u siguruar që ato të jenë sa më të qarta dhe të zbatueshme.

Rekomandimet përfshihen në tekstin e raportit përfundimtar dhe lidhen drejtpërdrejt me mangësitë e identifikuara, duke iu referuar angazhimeve, detyrimeve e standardeve të veçanta. Ato, gjithashtu, paraqiten së bashku në fund të raportit, në numër të kufizuar (zakonisht katër deri në dhjetë), të përcaktuara si përparësi. Mund t'iu referohen gjithashtu, rekomandimeve të mëparshme të ODIHR-it, të cilat ende nuk janë trajtuar, duke përfshirë raportet e mëparshme të vëzhgimit, si dhe opinioneve ligjore. Këto rekomandime formojnë bazën për çdo aktivitet zbatues në të ardhmen, duke u dhënë përparësi rekomandimeve prioritare.

Rekomandimet e ODIHR-it nuk janë as të prera dhe as shteruese dhe shtetet pjesëmarrëse mund të duan të shkojnë përtej rekomandimeve të ODIHR-it në përpjekjet e tyre për të përmirësuar proceset zgjedhore. Për këtë qëllim mund të merren parasysh edhe rekomandimet e qytetarëve vëzhgues, OAZ-ve dhe organizatave të tjera ndërkombëtare.

4.2 Paraqitja e raportit përfundimtar

Paraqitja i Raportit Përfundimtar përbën një mekanizëm efektiv për të kaluar nga faza e vëzhgimit tek ajo e ndihmës për shtetet pjesëmarrëse në zbatimin e rekomandimeve. Kur raporti përfundimtar u dërgohet shtetit pjesëmarrës, ODIHR-i pohon gatishmërinë e tij për të ndërmarrë një vizitë për ta paraqitur raportin në vend dhe për të diskutuar rekomandimet që përmban ai. Kjo ftesë u ofrohet të gjitha shteteve pjesëmarrëse; megjithatë, vizita do të kryhet vetëm në bazë të kërkesës së autoriteteve shtetërore. Vizitat për të paraqitur raportin përfundimtar, zakonisht, do të udhëhiqen nga kryetari i veprimtarisë përkatëse të vëzhgimit, nga një zyrtar i lartë i ODIHR-it ose nga Drejtori i ODIHR-it. E mira do të ishte që vizita të zhvillohej nga tre deri nëntë muaj pas zgjedhjeve.

Gjatë vizitës, raporti u paraqitet zyrtarisht një sërë bashkëbiseduesve dhe diskutimet iu përmbahen gjetjeve, përfundimeve dhe rekomandimeve kryesore të raportit. Vizita mund të përfshijë takime dypalëshe, mbledhje informuese në parlament, tryeza të rrumbullakëta, takime në grupe pune, dhe, në disa raste, konferenca për shtyp. Vizita të tilla ofrojnë një mundësi për të zhvilluar dialog konstruktiv me autoritetet, për të sqaruar çdo fushë që nuk është kuptuar plotësisht dhe për të diskutuar mënyrat, në të cilat ODIHR-i mund t'u vijë në ndihmë shteteve për zbatimin e rekomandimeve. Pas vizitës, ODIHR-i bën publike pikat kyçe të takimeve dhe diskutimeve.

4.3 Aktivitetet për zbatimin e rekomandimeve për zgjedhjet

Zbatimi i rekomandimeve përfshin një gamë aktivitete të ndërmarra nga shtetet pjesëmarrëse, ndonjëherë me mbështetjen e ODIHR-it dhe aktorëve të tjerë ndërkombëtarë. Këto aktivitete përqendrohen në trajtimin e rekomandimeve për zgjedhjet, të cilat mund të përfshijnë edhe çështje më të gjera të zhvillimit demokratik dhe mbrojtjes së të drejtave të njeriut, si: liria e pjesëmarrjes në shoqata, e tubimit dhe lëvizjes, si dhe të mbështetjes për partitë politike, gjyqësorin, mediat dhe palët e tjera të interesuara në zgjedhje. Aktivitetet zbatuese që mund të ndërmerren nga ana e shteteve pjesëmarrëse dhe ODIHR-it, diskutohen me hollësi në Kapitullin 6.

Më e mira është që zbatimi të fillojë sa më shpejt që të jetë e mundur pas përfundimit të procesit zgjedhor. Brenda ciklit zgjedhor, periudha kohore, menjëherë pas përfundimit të zgjedhjeve, është zakonisht më e përshtatshme për të trajtuar pjesën më të madhe të përbërësve të zgjedhjeve, ku përfshihen ndryshimet themelore të kuadrit ligjor, regjistrimi i zgjedhësve, kufijtë e qarqeve zgjedhore, administrimi i zgjedhjeve, financimi i fushatës dhe mekanizmat e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve zgjedhore. Përfundimi i aktiviteteve zbatuese duhet të planifikohet me kujdes. Ndryshimet që mund t'u bëhen elementeve bazë të procesit në kohë shumë të afërt me zgjedhjet, mund të hasin në kundërshti dhe mund të mos lënë kohë të mjaftueshme për diskutimin dhe zbatimin e duhur. Kjo vlen veçanërisht për reformat ligjore. Praktika e mirë e Komisionit të Venecias tregon se elementet themelore të ligjit zgjedhor nuk duhet të ndryshohen në vitin para zgjedhjeve.

Gjatë periudhës paszgjedhore mund të ndërmerren mjaft aktivitete të ndryshme dhe plotësuese për zbatimin e rekomandimeve. Për shembull, mund të mbahet një tryezë e rrumbullakët për angazhimet e OSBE-së kundrejt një teme të caktuar zgjedhore, e cila, nga ana tjetër, mund të pasohet nga një rishikim formal i projektit për ndryshimin e ligjit. ODIHR-i mund të shfrytëzojë

edhe mundësinë për të kryer një vizitë rishikuese afatmesme, ndërmjet zgjedhjeve, për të vlerësuar shkallën e zbatimit dhe, ndoshta, për të nxitur reforma të mëtejshme. Në të gjitha rastet, aktivitetet ndjekëse-zbatuese të ODIHR-it përfundojnë para dërgimit të misionit të vlerësimit të nevojave.

4.4 Misionet e vlerësimit të nevojave

Edhe pse nuk janë aktivitete zbatuese në kuptimin e ngushtë të fjalës, MVN-të parazgjedhore japin mundësinë për të vlerësuar masën, në të cilën rekomandimet e mëparshme janë trajtuar në një fazë të mëvonshme të ciklit zgjedhor. Zakonisht, ODIHR-i dërgon një MVN në një shtet pjesëmarrës, nga katër deri në gjashtë muaj para datës së zgjedhjeve. MVN-ja vlerëson mjedisin parazgjedhor dhe rekomandon nëse është i këshillueshëm ndonjë aktivitet i lidhur me zgjedhjet, dhe nëse po, çfarë lloj aktiviteti i plotëson më mirë nevojat e identifikuara. Kur rekomandon ndonjë aktivitet të mundshëm lidhur me zgjedhjet, MVN-ja merr në konsideratë një sërë kriteresh, përfshirë masën, në të cilën janë zbatuar rekomandimet nga aktivitetet e mëparshme të vëzhgimit të zgjedhjeve të ODIHR-it. Të gjitha raportet e MVN-së bëhen publike në faqen e internetit të ODIHR-it.

Vlerësimi i MVN-së për masën, në të cilën janë zbatuar rekomandimet, duhet të nxjerrë në pah ato që janë trajtuar dhe ato që mbeten të pazgjidhura. MVN-ja duhet të vlerësojë shpejtësinë, karakterin shterues dhe gjithëpërfshirjen e procesit zbatues. Ky vlerësim kontribuon në rekomandimin e MVN-së nëse duhet ndërmarrë një aktivitet vëzhgues për zgjedhjet. Moszbatimi i rekomandimeve të mëparshme të ODIHR-it nga një shtet pjesëmarrës mund ta bëjë të pakuptimtë kryerjen e një aktiviteti të ODIHR-it, pasi rekomandimet e tij ka të ngjarë të jenë një përsëritje e atyre që janë bërë më parë.

Nëse MVN-ja rekomandon që të mos kryhet aktivitet vëzhgimi për zgjedhjet, megjithatë ajo mund të tërheqë vëmendjen tek rekomandimet ose çështjet që kërkojnë zgjidhje. Kjo pastaj, mund të shërbejë si bazë për aktivitetet e mundshme zbatuese të ODIHR-it, në mbështetje të shtetit pjesëmarrës.



5. Praktika e mirë për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve për zgjedhjet

ODIHR-i ka një histori të gjatë pune me shtetet për zbatimin e rekomandimeve për zgjedhjet. Si rrjedhojë, janë krijuar një sërë praktikash të mira, që rrisin mundësitë e zbatimit të efektshëm të rekomandimeve dhe të reformës zgjedhore në mënyrë më të gjerë. Këtu përfshihet:

1. **Vullneti politik dhe qëndrueshmëria.** Qeveria ka përgjegjësinë kryesore për zbatimin e rekomandimeve, duke pasur parasysh pushtetin e saj ekzekutiv dhe fuqinë parlamentare. Për këtë arsye, vullneti i vërtetë politik nga partia (apo partitë) qeverisëse është thelbësor për zbatimin e efektshëm të rekomandimeve. Për shembull, kjo mund të demonstronhet përmes hyrjes në një dialog kombëtar rreth reformës dhe hartimit të planeve konkrete të veprimit. Megjithatë ODIHR-i mund t'u asistojë shteteve përmes aktiviteteve për zbatimin e rekomandimeve, në mënyrë që ky proces të jetë i vazhdueshëm dhe me autorësi vendase, është e

domosdoshme që procesi të udhëhiqet brenda për brenda vendit. ODIHR-i vlerëson se përgjegjësia kryesore për organizimin e zgjedhjeve u takon shteteve pjesëmarrëse dhe se, për këtë arsye, aktivitetet e tij për zbatimin e rekomandimeve mbështesin kapacitetet për një menaxhim të qëndrueshëm të zgjedhjeve.

2. **Zhvillimi i reformës në kohë.** Qëndrueshmëria e ligjit ka një rëndësi thelbësore për procesin zgjedhor dhe zbatimin e rekomandimeve në kohë të mjaftueshme para zgjedhjeve lejon kohë për konsultime, për hartimin dhe miratimin e legjislatcionit; për testime dhe zhvillim praktikash; për programe informimi për zgjedhësit, si dhe për trajnimin e stafit zgjedhor, kandidatëve të mundshëm dhe aktorëve të tjerë. Kur zgjedhjet nuk janë shumë afër, ka edhe më pak rrezik që diskutimet të bëhen politikisht të nxehta, që do të thotë se qëndrimet mund të shqyrtohen në mënyrë më të hollësishme. Shtimi i vullnetit politik dhe arritja e kompromiseve politike kërkojnë kohë dhe të punuarit me afate të ngjeshura nuk i shërben gjithmonë ndërmarrjes së negociatave të ndërlikuara politike. Zbatimi i rekomandimeve në minutën e fundit rrezikon që të perceptohet si dashakeq dhe si i diktuar nga interesa të ngushta politike. Përmirësimet zgjedhore kërkojnë kohë që të planifikohen dhe të vihen në zbatim, gjë që shpesh kërkon përfshirjen e shumë aktorëve. Prandaj, prej këtej rrjedh edhe vlera e madhe që ka rishikimi i rekomandimeve dhe iniciimi i reformës sa më herët që të jetë e mundur pas zgjedhjeve.
3. **3. Konsultimet dhe gjithëpërfshirja.** Konsensusi mbi mënyrën e zbatimit të rekomandimeve është i rëndësishëm me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes në procesin e reformës dhe pranimin e rezultateve. Reformimi i kuadrit ligjor ka të bëjë në thelb me ndryshimin e rregullave të lojës dhe nuk duhet të jetë kompetencë ekskluzive e fituesit të zgjedhjeve të fundit. Prosesi i reformës është më i fortë kur ka pjesëmarrje, konsultime dhe përfshirje të konsiderueshme jo vetëm të partive kryesore opozitare, por edhe të grupeve më të vogla politike, organeve të administrimit të zgjedhjeve, ekspertëve vendas, shoqërisë civile dhe aktorëve të tjerë, përfshirë edhe ata që janë në rrezik të anashkalohen gjatë procesit (shih Kapitullin 9). Shembujt e praktikës së mirë përfshijnë ngritjen e komisioneve parlamentare shumëpartiake; grupeve të punës të iniciuara nga organet e administrimit të zgjedhjeve ose nga shoqëria civile; dhe konsultimet e rregullta publike dhe programet e ndërgjegjësimit.
4. **Kuadri dhe përgjegjësitë, për të cilat bihet dakord.** Zbatimi i rekomandimeve për zgjedhjet mund të jetë një proces politikisht përçarës. Të pasurit e një kuadri objektivash, për të cilat është rënë dakord, mund të ndihmojë në ruajtjen e fokusit dhe mund ta lehtësojë identifikimin e rrugës që duhet ndjekur më tej dhe rënien dakord për të. Ndarja e

përgjegjësi të veçanta mes agjencive të ndryshme rrit mundësitë për zbatimin e rekomandimeve. Edhe të pasurit e një kalendarit të miratuar hapash rrit shtysat për zhvillimin dhe përgjegjshmërinë e këtyre hapave. Krijimi i mekanizmave të rishikimit periodik të ecurisë nxit dinamizmin dhe krijon hapësirë për rikalibrime të aktiviteteve, nëse është e nevojshme. Kjo krijon mundësinë për të verifikuar nëse reformat e propozuara janë në përputhje me angazhimet e OSBE-së dhe detyrimet e standardet e tjera ndërkombëtare për zgjedhje demokratike. Raportimi publik mbi reformën zgjedhore rrit llogaridhënien dhe transparencën dhe ofron nivele më të larta të besimit politik dhe publik tek procesi.

5. **Bashkërendimi dhe kohezioni.** Bashkërendimi mes agjencive kombëtare dhe ndërkombëtare, që ofrojnë mbështetje për zbatimin e rekomandimeve, rrit mundësinë që kjo mbështetje të jetë e efektshme, pasi pakëson përsëritjet dhe krijon mundësi për një proces të integruar të zbatimit të rekomandimeve. Këtu mund të përfshihen nisma të përbashkëta, takime periodike bashkërenduese dhe mekanizma të përbashkët rishikimi. Në veçanti, mund të bëhen rishikime afatmesme për të vlerësuar në mënyrë të përbashkët ecurinë e zbatimit të rekomandimeve, si dhe për të inkurajuar dhe këshilluar për hapa të tjerë që mund të merren.



6. Shembuj të aktiviteteve për ndjekjen e zbatimit e rekomandimeve

Zbatimi i rekomandimeve për zgjedhjet mund të ndërmerret nga autoritetet shtetërore dhe aktorët joshetërorë të një shteti pjesëmarrës. Këto përpjekje mund t'i mbështesin aktivitetet e dedikuara të ODIHR-it dhe organizatave të tjera ndërkombëtare për zbatimin e rekomandimeve.

Në këtë kapitull jepen disa shembuj të aktiviteteve të zbatimit të rekomandimeve, që mund të ndërmerren si nga aktorë vendas, ashtu edhe nga ODIHR-i. Shembujt e përshkruar janë thjesht për qëllime demonstrimi, por aktivitetet duhet t'u përshtaten rrethanave të veçanta të një shteti të caktuar dhe objektivave të procesit të zbatimit të rekomandimeve. Megjithëse disa nga këto aktivitete mund të ndërmerren në mënyrë të pavarur, shpeshherë ndërthurja e masave mund të rezultojë më i efektshëm në kryerjen e një procesi të suksesshëm të zbatimit të rekomandimeve. Në të gjitha rastet bashkëpunimi i ngushtë mes ODIHR-it dhe aktorëve vendas është i domosdoshëm për nxitjen e një reforme të integruar dhe të qëndrueshme.

6.1 Aktivitetet për zbatimin e rekomandimeve nga shteti pjesëmarrës

Aktiviteti	Agjencia që mund të drejtojë procesin	Përshkrimi
Rishikimi i legjislacionit	Parlamenti Komisionet parlamentare	<p>Organet legjislative, përfshirë edhe komisionet parlamentare, mund të shqyrtojnë mbajtjen e zgjedhjeve dhe të përgatisin rekomandimet për të përmirësuar mbajtjen e zgjedhjeve të ardhshme, si dhe të shqyrtojnë rekomandimet për zgjedhjet të përgatitura nga ODIHR-i, organizma të tjera ndërkombëtare dhe OSHC të tjera. Në shumë vende, komisionet parlamentare kanë nisur procese të konsultimit publik për të kërkuar mendime mbi reformat e mundshme nga një shkallë e gjerë e grupeve të interesit. Kjo mund të bëhet me anë të takimeve, seminareve, medias dhe programeve përmes internetit.</p> <p>Në vijim, organet legjislative dhe komisionet parlamentare mund të përgatisin dhe miratojnë legjislacionin që duhet shqyrtuar para rekomandimeve të ODIHR-it, me qëllim përmirësimin e kuadrit ligjor dhe mbajtjes së zgjedhjeve të ardhshme.</p> <p>Parlamentet, gjithashtu, mund të nxisin reformën duke këqyru me kujdes punën e organeve të administrimit të zgjedhjeve.</p>
Rishikimi i zgjedhjeve dhe planifikimi strategjik	Organet e administrimit të zgjedhjeve Grupet e punës Njësitë e posaçme	<p>Organet e administrimit të zgjedhjeve mund të shqyrtojnë mbajtjen e zgjedhjeve dhe të përgatisin një plan strategjik për reformën. Ato mund të bëjnë përmirësime që janë brenda kompetencave të tyre dhe të përgatisin rekomandime për ndryshimet ligjore, që mund të shqyrtojnë parlamenti. Në disa shtete, organet e administrimit të zgjedhjeve kanë të drejtën e nismës ligjore dhe mund të propozojnë edhe ato vetë projektligje.</p> <p>Në analizat dhe planet e tyre strategjike, organet e administrimit të zgjedhjeve mund të vlerësojnë dhe të bëjnë komente deri në çfarë shkalle janë adresuar rekomandimet e përgatitura nga ODIHR-i, organizmat të tjera ndërkombëtare dhe OSHC-të. Proceset e drejtuara nga organet e administrimit të zgjedhjeve shpesh janë gjithëpërfshirëse, përfshirë dhe konsultime me agjenci të tjera shtetërore, parti politike, shoqërinë civile, ODIHR-in dhe organizata të tjera ndërkombëtare.</p> <p>Nisma të ngjashme mund të ndërmerren nga njësi të posaçme ose grupe pune me mandat të veçantë, që mund të kenë interes për një element të veçantë. Ndonjëherë, njësi të posaçme ose grupe të tilla pune mund të kenë në përbërje edhe përfaqësues dhe ekspertë nga organizata ndërkombëtare.</p>

Aktiviteti	Agjencia që mund të kryesojë procesin	Përshkrimi
<p>Analizat, mbështetja dhe monitorimi nga OSHC-të</p>	<p>Grupet e vëzhguesve qytetarë</p> <p>Fondacionet politike, grupet e ekspertëve</p> <p>OSHC të tjera</p>	<p>OSHC-të mund të organizojnë diskutime në tryeza të rumbullakëta dhe aktivitete të tjera për të përgatitur rekomandimet e veta dhe për të monitoruar se sa po zbatohen apo sa janë zbatuar rekomandimet. Kjo mund të çojë në hapa mbështetëse për të nxitur autoritetet dhe aktorët e tjerë që të zbatojnë rekomandimet. Në shtetet pjesëmarrëse, ku nuk ka mjaftueshëm vullnet politik nga autoritetet sa i përket reformës, mbështetja e OSHC-ve mund të jetë një aktivitet i dobishëm për nxitjen e zbatimit të rekomandimeve, sidomos në rastet kur OSHC-të krijojnë platforma të përbashkëta mbështetjeje rreth përparësive kryesore të reformave, siç është regjistrimi i zgjedhësve apo pjesëmarrja e grave.</p> <p>OSHC-të mund të bëjnë raporte dhe deklarata për shtyp gjatë periudhës paszgjedhore, duke vlerësuar zbatimin e reformave të miratuara dhe duke u mëshuar çështjeve që kërkojnë vëmendje të mëtejshme.</p>
<p>Raportimi vullnetar në Këshillin e Përhershëm të OSBE-së dhe në Komitetin e Dimensionit Njerëzor</p>	<p>Ekzekutivi</p> <p>Parlamenti</p>	<p>Në përputhje me angazhimet e OSBE-së, shtetet pjesëmarrëse po paraqesin në Këshillin e Përhershëm dhe në Komitetin e Dimensionit Njerëzor gjithnjë e më shumë raporte me vullnetin e tyre, mbi zbatimin e rekomandimeve të ODIHR-it për zgjedhjet.</p> <p>Sa herë që është e mundur, ODIHR-i mund të marrë pjesë në këto takime, për të ofruar informacion shtesë dhe ekspertizë teknike për të lehtësuar diskutimet e thelluara.</p>
<p>Raportimi në organet e OKB-së për monitorimin e traktateve, RPU-ja dhe mekanizmat e tjerë</p>	<p>Ekzekutivi</p>	<p>Shtetet pjesëmarrëse, gjithashtu, mund ta shfrytëzojnë mundësinë për të komentuar mbi zbatimin nga ana e tyre të rekomandimeve për zgjedhjet, në kuadër të raporteve të tyre periodike në organet e OKB-së për monitorimin e traktateve, RPU-së dhe instrumenteve të tjera rajonale, ku mund të jenë palë. Kjo mund të jetë një mundësi për të vënë në dukje aktivitetet e ndërmarra për shqyrtimin e rekomandimeve të ODIHR-it, veçanërisht kur ato përkrijnë me ato të organizatave të tjera ndërkombëtare.</p>

6.2 Aktivitete për zbatimin e rekomandimeve për zgjedhjet nga ODIHR-i

Aktiviteti	Përshkrimi
<p>Analizat ligjore</p>	<p>Me kërkesë të vetë shteteve pjesëmarrëse, ODIHR-i i asiston ato përmes analizimit të projektligjeve dhe ligjeve të miratuara për të parë nëse ato janë në përputhje me angazhimet e OSBE-së dhe detyrimet dhe standardet e tjera ndërkombëtare. Këtu përfshihet legjislacioni për zgjedhjet, si dhe ligje të tjera që prekin çështje të drejtave të njeriut që janë pjesë përbërëse të krijimit të kushteve të nevojshme për zhvillimin e zgjedhjeve të vërteta, si: liria për t'u mbledhur, për t'u organizuar dhe për t'u shprehur, si dhe legjislacioni mbi partitë politike dhe financimin e tyre.</p> <p>Avantazhi i analizave ligjore është se ato konsolidojnë opinionin e ekspertëve mbi shkallën e përputhshmërisë së legjislacionit me angazhimet e OSBE-së dhe me detyrimet e standardet e tjera ndërkombëtare. Avantazh përbëjnë veçanërisht analizat e projektligjeve, pasi ato krijojnë mundësi për këshillime të tjera të paanshme nga jashtë që mund të merren parasysh para se legjislacioni i propozuar të dërgohet në parlament për miratim.</p> <p>Analizat ligjore në fushën e zgjedhjeve kryhen zakonisht bashkërisht me Komisionin e Venecias në formën e "Opinionëve të Përbashkëta". ODIHR-i ka statusin e vëzhguesit në seancat plenare të Komisionit të Venecias dhe në takimet e Këshillit për Zgjedhje Demokratike, që varet prej tij. Kërkesat për analiza ligjore, zakonisht, paraqiten drejtpërdrejt nga shtetet pjesëmarrës ose, në disa raste, përmes institucioneve të OSBE-së ose të Këshillit të Evropës. ODIHR-i nuk merr parasysh kërkesa që bëhen nga individë apo organizata joqeveritare. Të gjitha Opinionet e Përbashkëta publikohen në faqen e internetit të ODIHR-it.</p> <p>Pas analizës ligjore, ODIHR-i është i disponueshëm që ta vizitojë shtetin përkatës për të paraqitur raportin dhe për të diskutuar ndryshimet e rekomanduara me palët e interesuara.</p>
<p>Ekspertiza ligjore në hartimin e legjislacionit</p>	<p>Gjatë procesit të hartimit të legjislacionit për zgjedhjet ODIHR-i mund t'u ofrojë shteteve pjesëmarrëse ekspertizë ligjore, përfshirë dhe komisioneve parlamentare dhe grupeve të punës të ngarkuara me analizimin dhe hartimin e amendamenteve. ODIHR-i mund të ofrojë këshillim në lidhje me shkallën në të cilën amendamentet e propozuara përfshijnë rekomandimet e mëparshme të ODIHR-it dhe përputhen me angazhimet e OSBE-së dhe detyrimet e standardet e tjera ndërkombëtare.</p> <p>ODIHR-i u ka ofruar komente informale me shkrim komisioneve parlamentare dhe grupeve të punës, ka marrë pjesë në seancat e tyre dhe ka bërë vizita të posaçme për t'i diskutuar propozimet në mënyrë më të hollësishme. Ndonjëherë, kjo është bërë në bashkëpunim me Komisionin e Venecias.</p> <p>Më gjerësisht, ODIHR-i mund të analizojë tërësinë e procedurave të ligjvënës në një shtet pjesëmarrës për t'u siguruar që ato parashikojnë një proces të efektshëm, transparent dhe gjithëpërfshirës.</p>

Aktiviteti	Përshkrimi
<p>Vlerësime të thelluara të përbërësve të posaçëm të zgjedhjeve</p>	<p>ODIHR-i mund të dërgojë një ekip ekspertësh për një vlerësim të hollësishëm të përbërësit e posaçëm të zgjedhjeve. Format i këtyre vlerësimeve mund të variojë nga vizita të shkurtra prej tre deri pesë ditësh, e që përfshijnë vetëm punonjës të ODIHR-it, e deri në vizita të zgjeruara prej 10 deri 14 ditësh, që përfshijnë edhe konsulentë të specializuar jashtë ODIHR-it.</p> <p>ODIHR-i ka ndërmarrë vizita në shtetet pjesëmarrëse për të ofruar vlerësime të thelluara të propozimeve të shteteve për futjen e teknologjive të reja të votimit, si dhe për krijimin e sistemeve për administrimin e zgjedhjeve dhe regjistrimin e zgjedhësve. Këto vlerësime mund t'i dërgohen shtetit pjesëmarrës në mënyrë të drejtpërdrejtë, mund të paraqiten në tryeza të rrumbullakëta apo aktivitete të tjera, ose mund të publikohen në faqen e internetit të ODIHR-it.</p> <p>ODIHR-i mund të përfshihet edhe në vlerësimin e çështjeve më të zgjeruara të demokracisë dhe të të drejtave të njeriut, që dalin nga gjetjet dhe rekomandimet e vëzhgimit të zgjedhjeve, përfshirë sundimin e ligjit; administratën publike; regjistrimin e popullsisë; financat politike; lirinë e shprehjes, organizimit dhe mbledhjes; rolin e partive politike; si dhe pjesëmarrjen politike të grave, romëve dhe romëve sinti, pakicave të tjera dhe personave me aftësi të kufizuara.</p>
<p>Këshillim teknik për zbatimin e rekomandimeve dhe praktikave të tjera të mira zgjedhore</p>	<p>ODIHR-i mund të ofrojë këshillim teknik për zbatimin e rekomandimeve për zgjedhjet dhe për praktikat e mira për përbërësit e identifikuar të zgjedhjeve. Kjo mund të bëhet përmes pjesëmarrjes në tryeza të rrumbullakëta, seminare ose takime.</p> <p>Shembujt përfshijnë aktivitete mbi praktikat e mira për reformën legjislative, modele të përcaktimit të kufijve zgjedhorë, procedurat e regjistrimit të kandidatëve, sisteme të ndryshme të administrimit të zgjedhjeve, rolin e partive politike në zbatimin e rekomandimeve për zgjedhjet, masa për përmirësimin e sistemeve për regjistrimin e zgjedhësve, praktika të mira lidhur me teknologjitë e reja të votimit, forcimin e mekanizmave mbikëqyrës për financimin e fushatave, krijimin e sistemeve efikase për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve zgjedhore dhe nxitjen e pjesëmarrjes së grave dhe romëve.</p> <p>Këto aktivitete, shpesh, organizohen nga misionet në terren të OSBE-së, organizata të tjera ndërkombëtare ose nga autoritetet e shtetit pjesëmarrës. ODIHR-i mund të organizojë edhe aktivitete tematike për pjesëmarrjen e përfaqësuesve përkatës të shtetit dhe shoqërisë civile të një sërë shtetesh pjesëmarrëse të OSBE-së. ODIHR-i është i angazhuar të përfshijë në këto aktivitete edhe opozitën dhe partitë joparlamentare, shoqërinë civile dhe grupet e papërfaqësuara sa duhet politikisht.</p> <p>ODIHR-i ruan një bazë të dhënash të profesionistëve të kualifikuar, që mund të ofrojnë këshillim teknik për çështje të</p>

Aktiviteti	Përshkrimi
Mbështetje për grupet e vëzhguesve qytetarë	<p>ODIHR-i u ka ofruar mbështetje grupeve të vëzhguesve qytetarë për shumë vite. Këtu përfshihet trajnimi dhe mbështetja e tyre për krijimin e kapaciteteve të këtyre grupeve në fushat e metodologjisë së vëzhgimit, aftësitë për të shkruar raporte, rishikimin e zbatimit të rekomandimeve dhe lehtësimin e dialogut me partitë politike për reformën dhe mbështetjen për reformën zgjedhore.</p> <p>ODIHR-i mund të ndihmojë në rritjen e profilit të grupeve të vëzhguesve qytetarë, duke çuar përpara reformën zgjedhore në mënyrë gjithëpërfshirëse dhe duke vënë në pah, sipas rastit, rekomandimet e tyre.</p> <p>ODIHR-i ka publikuar edhe një manual për mbështetjen e grupeve të vëzhguesve qytetarë dhe ofron trajnim falas përmes internetit për vëzhguesit e zgjedhjeve. Gjithashtu, ODIHR-i mund të organizojë seminare për çështje që mund të jenë me interes të veçantë për vëzhguesit qytetarë..</p>
Vizita për shqyrtim afatmesëm	<p>Në varësi të vullnetit politik të shteteve pjesëmarrëse, ODIHR-i mund të kthehet në vendet ku ka vëzhguar zgjedhjet për një rishikim afatmesëm për të theksuar edhe një herë rekomandimet dhe për të vlerësuar shkallën e zbatimit të tyre. Këto vizita mund të ndihmojnë për t'u kujtuar shteteve pjesëmarrëse angazhimin e tyre afatgjatë për të zbatuar rekomandimet dhe për t'i inkurajuar ato që të ndërmarrin hapa për të nxitur zbatimin e tyre.</p>
Lehtësimi dhe bashkërendimi	<p>ODIHR-i mund të ndihmojë për krijimin e një mjedisi të përshtatshëm për reformë zgjedhore, duke lehtësuar dhe duke bashkërenduar përpjekjet mes aktorëve vendas për zbatimin e rekomandimeve, si dhe me organizatat e tjera ndërkombëtare. Gjetjet dhe rekomandimet e aktiviteteve për vëzhgimin e zgjedhjeve mund të ofrojnë një udhërrëfyes për reformën e ardhshme, ndërsa tradita e gjatë e punës së ODIHR-it me reformat zgjedhore mund të ofrojë praktika krahasuese nga shtete të tjera, që mund të ndihmojnë në krijimin e një kornize për zbatimin e rekomandimeve.</p> <p>Përveç kësaj, ODIHR-i mund të ndihmojë dhe për lehtësimin e përpjekjeve për zbatimin e rekomandimeve, duke nxitur dialogun politik dhe duke bashkërenduar përparësitë e reformave mes homologëve vendas dhe organizatave ndërkombëtare.</p>

Shembulli 1: Rishikimi i legjislacionit

Vitet e fundit, një sërë shtetesh pjesëmarrëse të OSBE-së kanë ndërmarrë rishikime të legjislacionit, si një mënyrë për të përmirësuar proceset e tyre zgjedhore dhe për t'i përafëruar ato me angazhimet e OSBE-së. Në një rast të tillë, parlamenti ngriti një komision të posaçëm të ngarkuar veçanërisht me shqyrtimin e rekomandimeve të ODIHR-it, në një kod të rishikuar zgjedhor. Përveç të gjitha partive parlamentare, komisioni përfshinte edhe përfaqësues nga administrata zgjedhore dhe nga shoqëria civile. Komisioni hartoi një plan pune në mbledhjen e tij të parë, që përcaktonte temat kryesore për t'u trajtuar në mbledhjet e mëvonshme dhe vendosi afate të qarta për finalizimin e tyre.

Komisioni kërkoi ekspertizë nga ODIHR-i dhe, para çdo mbledhjeje, ODIHR-i përgatiste dhe dërgonte disa rekomandime, bazuar në raportet e mëparshme dhe në përvojat krahasuese, për t'u marrë parasysh nga grupi i

punës. Më pas, ekspertët e ODIHR-it morën pjesë në mbledhjet e komisionit, duke ofruar komente mbi përputhshmërinë e projekt-dispozitave me angazhimet e OSBE-së dhe me standardet e tjera ndërkombëtare. Mbledhjet e komisionit ishin të hapura për publikun dhe në to u parashtruan një sërë pikëpamjesh të ndryshme para se pjesëmarrësit të binin përfundimisht dakord për disa reforma që trajtonin pjesën më të madhe të rekomandimeve të ODIHR-it. Pas një procesi tjetër konsultimi me publikun e gjerë, ndryshimet e propozuara ligjore u miratuan nga parlamenti, 18 muaj para zgjedhjeve të radhës. Anëtarë të ndryshëm të komisionit u shprehën në favor se konsultimet e gjera, ndonëse shpesh merrnin shumë kohë, rezultuan të ishin një mënyrë efektive për të nxitur pjesëmarrje në procesin e reformës dhe një pranim të gjerë të rezultateve.

Shembulli 2: Rishikimi i zgjedhjeve dhe planifikimi strategjik

Pranohet gjerësisht se të gjitha proceset zgjedhore mund të përfitojnë nga përmirësimet e vazhdueshme për t'u siguruar se ato vazhdojnë të mbeten të efektshme dhe elastike ndaj sfidave të reja, që priten të ndodhin. Në shumë vende, kjo ka përfshirë përpjekjet e bëra për modernizimin e sistemeve për regjistrimin e zgjedhësve, për të garantuar saktësinë dhe efektshmërinë e tyre, sidomos në kohën kur popullatat lëvizin gjithnjë e më shumë nga njëri vend në tjetrin. Në një rast të fundit, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i një shteti pjesëmarrës bëri një studim pas zgjedhjeve, i cili identifikoi krijimin e një regjistri të zgjedhësve, të centralizuar dhe elektronik, si prioritet kyç për garantimin e saktësisë së listës së zgjedhësve. Në konsultim me agjenci të tjera shtetërore në këtë fushë, ky komision hartoi një strategji fillestare për zbatimin dhe kërkoi nga ODIHR-i këshillim në nivel ekspertësh, në lidhje me propozimin e tij, për t'u siguruar se ai propozim ishte në përputhje me angazhimet e OSBE-së dhe me rekomandimet e mëhershme të ODIHR-it.

Mbi këto baza, ODIHR-i dërgoi një ekip ekspertësh, në vend, për disa ditë, për t'i diskutuar propozimet si me autoritetet, ashtu edhe me shoqërinë civile. Kjo vizitë çoi në një raport vlerësimi të thelluar, i cili përfshiu edhe disa rekomandime për përmirësime të mëtejshme. Ky raport iu dërgua autoriteteve, u publikua në faqen e internetit të ODIHR-it dhe u paraqit në një tryezë të rrumbullakët publike, e cila u organizua bashkë me Komisionin Qendror të Zgjedhjeve. Kjo tryezë e rrumbullakët rezultoi e efektshme sa i përket theksimit të shqetësimeve të aktorëve të ndryshëm, përfshirë edhe nevojën për sigurimin e komunikimit të mjaftueshëm me grupet e anashkaluara, si gratë në zonat rurale dhe komunitetet rome. Si rrjedhojë e kësaj tryeze të rrumbullakët, komuniteti ndërkombëtar i ofroi mbështetje një koalicioni grupesh të shoqërisë civile, i cili – së bashku me Komisionin Qendror të Zgjedhjeve – ndërmori një fushatë të zgjeruar për regjistrimin e zgjedhësve, e cila jo vetëm siguroi nivel të lartë përfshirjeje, por edhe ndihmoi për krijimin e besimit në procesin e reformës.

Shembulli 3: Mbështetja e shoqërisë civile

Organizatat e shoqërisë civile mund të luajnë rol konstruktiv në vlerësimin e shkallës së zbatimit të rekomandimeve për zgjedhjet. Ato mund të ndihmojnë në identifikimin e sukseseve dhe mangësive dhe, rrjedhimisht,

të kontribuojnë në krijimin e një shtyse për reformë zgjedhore. Gjatë një procesi reforme zgjedhore të kohëve të fundit, një koalicion grupesh të spikatura vëzhguesish qytetarë inicioi një projekt për monitorimin e shkallës së shqyrtimit të rekomandimeve. Në fillim të aktiviteteve të tyre, grupet publikuan disa kritere të qarta dhe objektive për vlerësimin e zbatimit jo vetëm të rekomandimeve që ata vetë kishin bërë, por edhe të atyre që kishin bërë organizata të tjera vendase dhe ndërkombëtare.

Gjatë procesit të reformës, koalicioni i shoqërisë civile bënte përditësime çdo dy muaj, ku përmendte zhvillimet pozitive, nxirrte në pah fushat që vazhdonin të kërkonin vëmendje dhe propozonte opsione të ndryshme për t'u marrë parasysh nga parlamenti. Koalicioni fitoi shpejt besimin e një game të gjerë palësh të interesuara në zgjedhje dhe përditësimet e tij, një herë në dy muaj, citoheshin gjerësisht nga partitë politike dhe nga komuniteti ndërkombëtar. Përveç raporteve të tij periodike, koalicioni mbajti edhe tryeza të rrumbullakëta dhe jepte herë pas here intervista në media. Përpjekjet e shoqërisë civile u vlerësuan gjerësisht si një mjet për të inkurajuar ndërgjegjësimin e publikut rreth procesit dhe për të nxitur përgjegjshmërinë dhe sensin e autorësisë së tij, ndër një numër të madh aktorësh politikë. Ato krijuan, gjithashtu, edhe një shkallë të madhe besimi mes autoriteteve dhe shoqërisë civile, rreth argumentimit dhe ndikimit të reformave.

Shembulli 4: Raportimi në Komitetin e Dimensionit Njerëzor të OSBE-së

Shtetet pjesëmarrëse po paraqesin gjithmonë e më shumë raporte me vullnetin e tyre në Komitetin e Dimensionit Njerëzor të OSBE-së, mbi ndjekjen nga ana e tyre të zbatimit të rekomandimeve për zgjedhjet. Në një shembull të kohëve të fundit, një shtet pjesëmarrës theksoi se si kishte ndërmarrë një proces gjithëpërfshirës reformash, bazuar në raportet dhe rekomandimet e Komisionit të tij Qendror të Zgjedhjeve dhe ato të misionit të vëzhgimit të zgjedhjeve të ODIHR-it, si dhe në raportet e grupeve të ndryshme të vëzhguesve qytetarë dhe rekomandimet përkatëse të organeve monitoruese të traktateve të OKB-së. Ky shtet ofroi një përmbledhje të qartë të rekomandimeve, duke treguar se ku ishin bërë ndryshime në ligj dhe në praktikë, si dhe duke ofruar informacion lidhur me rrethanat se pse disa nga rekomandimet ende nuk ishin zbatuar. Vëmendje e veçantë iu kushtua edhe procesit të reformës, duke theksuar hapat e ndërmarrë për të hyrë në kontakt me partitë joparlamentare, shoqërinë civile, ekspertët vendas dhe aktorë të tjerë, përfshirë dhe ata që janë në rrezik të anashkalohen nga procesi, si: pakicat kombëtare dhe personat me aftësi të kufizuara. Dobia e vlerësimeve dhe rekomandimeve të ODIHR-it u theksua si pikënisja kyçe e reformës.

Pas paraqitjes së raportit të tyre, një sërë shtetesh të tjera drejtuan pyetje në lidhje me procesin e reformës, duke theksuar mbështetjen e tyre për zhvillimet pozitive, duke tërhequr në të njëjtën kohë vëmendjen tek rekomandimet, ende të pazbatuara, e duke dhënë sugjerime se si mund të zbatoheshin ato në bazë të përvojës së tyre. Kjo ofroi një mekanizëm të efektshëm vlerësimi paralel mes shteteve dhe një mjet të çmuar për shkëmbimin e praktikave të mira



CDL-AD(2011)042
Or. Engl.

Strasbourg, 19 December 2011

Opinion No. 641/ 2011

**EUROPEAN COMMISSION FOR DEMOCRACY THROUGH LAW
(VENICE COMMISSION)
AND
OSCE OFFICE FOR DEMOCRATIC INSTITUTIONS AND HUMAN RIGHTS
(OSCE/ODIHR)**

**JOINT OPINION
ON THE ELECTORAL LAW
AND THE ELECTORAL PRACTICE**

7. Partneriteti dhe bashkërendimi në ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve për zgjedhjet

Zbatimi i rekomandimeve për zgjedhjet mund të jetë i ndërlikuar dhe i ndjeshëm nga pikëpamja politike dhe përfshin një sërë aktorësh. Partneritetet e ODIHR-it me homologët vendas përbëjnë një komponent themelor për të gjitha aktivitetet për ndjekjen e rekomandimeve të tij. Ka edhe partneritete dhe mekanizma të tjerë, që mund të mbështesin ose të plotësojnë ndjekjen nga ana e ODIHR-it të zbatimit të rekomandimeve të tij, përfshirë dhe partneritetet me institucione të tjera brenda OSBE-së, me organizata të tjera ndërkombëtare dhe me komunitetin e donatorëve.

Prandaj, bashkërendimi mes këtyre aktorëve ka rëndësi të madhe për rritjen në maksimum të efektshmërisë, reduktimin e rreziqeve të përsëritjes ose boshllëqeve në ofrimin e mbështetjes dhe shmangien e dhënies së këshillave kontradiktore. Bashkërendimi funksionon më së miri në kontekstin e një strategjie gjithëpërfshirëse për ndjekjen e rekomandimeve, për të cilën bien dakord autoritetet e shtetit pjesëmarrës përkatës. ODIHR-i është në gjendje të luajë një rol qendror në sigurimin e bashkërendimit, orientimit dhe këshillimit mbi mënyrën se si mund të shqyrtohen më së miri rekomandimet për zgjedhjet.

7.1 Bashkërendimi me homologët kombëtarë

Bashkërendimi me homologët kombëtarë është thelbësor për një ndjekje gjithëpërfshirëse, të efektshme dhe të qëndrueshme të zbatimit të rekomandimeve për zgjedhjet. Teorikisht, autoritetet duhet të caktojnë një agjenci kryesuese për bashkërendimin e institucioneve, nxitjen e zbatimit të rekomandimeve dhe lehtësimin e shkëmbimit të informacionit dhe diskutimit mes palëve të interesuara në zgjedhje. Agjencia kryesuese mund të jetë një komision parlamentar, një njësi e posaçme pune, një grup pune i përbërë nga një sërë palësh të interesuara në zgjedhje ose një organ që merret me administrimin e zgjedhjeve. Me shumë gjasë, pikërisht kjo agjenci kryesuese do të ishte edhe pika kryesore e kontaktit për ODHR-in në çdo aktivitet për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve për zgjedhjet. Pavarësisht agjencisë kryesuese, rol kyç në zbatimin e rekomandimeve mund të luajnë edhe homologë të ndryshëm vendas. Këtu përfshihet organi që merret me administrimin e zgjedhjeve, autoritetet e tjera shtetërore, partitë politike dhe grupet e vëzhguesve qytetarë.

Organet e administrimit të zgjedhjeve (OAZ-të). Si organet kryesore zbatuese të legjislationit për zgjedhjet, OAZ-të kanë një këndvështrim unik të pikave të forta dhe të dobëta të procedurave ekzistuese. OAZ-të kryejnë shpesh vlerësime pas zgjedhjeve dhe hartojnë plane strategjike për zgjedhjet e ardhshme. Në disa vende, ato mund të kenë edhe kompetenca t'ia paraqesin projektligjet që propozojnë drejtpërdrejt parlamentit. Njohja thelbësore e procesit të zgjedhjeve nga OAZ-të përbën një burim kyç në ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve dhe përfshirja e tyre në proceset e reformave ndihmon për të garantuar që ndryshimet e propozuara të jenë të realizueshme në praktikë, si dhe për të krijuar sensin e autorësisë vendase të të gjithë procesit.

Autoritete të tjera shtetërore. Rol të ngjashëm mund të luajnë edhe autoritete të tjera shtetërore ose publike, përfshirë dhe transmetuesin publik, organet rregullatore të medias, gjyqësorin, organet kundër korrupsionit, organet e zbatimit të ligjit dhe agjencitë që kanë nën kontroll bazat e të dhënave të popullsisë dhe dokumentet e identitetit. Përvojat e tyre që lidhen me komponentë të veçantë të zgjedhjeve, mund t'i shtojnë vlerë të konsiderueshme procesit të zbatimit të rekomandimeve. Përveç kësaj, ato mund të jenë edhe në procesin e zbatimit të reformave më të zgjeruara, që ndikojnë në reformën zgjedhore.

Partitë politike. Të gjitha partitë politike, ato parlamentare dhe joparlamentare, mund të luajnë një rol aktiv në nxitjen e informimit dhe pjesëmarrjes së zgjedhësve. Përveç kësaj, partitë mund të mbrojnë, të debatojnë dhe të përcaktojnë përparësitë e axhendave ligjvënës. Është e domosdoshme që proceset e ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve për zgjedhjet të përfshijnë partitë politike, sidomos nëse ato janë të përfshira në nisma legjislative për zbatimin e rekomandimeve, ose nëse marrin pjesë në komisione parlamentare, të ngarkuara me reformën zgjedhore.

Grupet e vëzhguesve qytetarë. Grupet e vëzhguesve qytetarë dhe organizata të tjera të shoqërisë civile, si fondacionet politike apo grupet e ekspertëve, mund të luajnë rol të rëndësishëm në nxitjen dhe monitorimin e zbatimit të rekomandimeve. Këtu mund të përfshihen edhe analizat krahasuese, zhvillimi i konsultimeve publike, kryesimi i programeve për mbështetjen dhe paraqitja e propozimeve për reformë zgjedhore. Ata mund të ndërmarrin edhe vlerësime periodike mbi gjithëpërfshirjen dhe transparencën e procesit të zbatimit të rekomandimeve, si dhe mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve, të cilat mund të përdoren më pas, për të identifikuar fushat ku nevojiten ende përmirësime. Vëzhguesit qytetarë dhe shoqëria civile mund të luajnë rol të rëndësishëm në rritjen e ndërgjegjësimit të publikut rreth ndryshimeve dhe në monitorimin e zbatimit të tyre. Për këto arsye, përfshirja e shoqërisë civile mund të jetë komponent kyç i proceseve të zbatimit të rekomandimeve për zgjedhjet. Gjatë çdo procesi për zbatimin e rekomandimeve, ODIHR-i vendos dhe mban kontakte të mira me të gjithë homologët vendas, shpesh, përmes vizitave në vendin përkatës. Kjo ndihmon për nxitjen e gjithëpërfshirjes dhe ndërgjegjësimit mbi zhvillimet zgjedhore në shkallë vendi. Ajo ndihmon njëkohësisht edhe ODIHR-in që të ndjekë ecurinë e nismave për zbatimin e rekomandimeve dhe t'u ofrojë këshilla të konsoliduara organeve të përfshira në zbatimin e rekomandimeve.

7.2 Bashkërendimi me OSBE-në

Aktivitetet e ODIHR-it për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve për zgjedhjet mund të plotësohen edhe nga një sërë instrumentesh dhe institucionesh të OSBE-së, të cilat mund të nxisin dhe mbështesin zbatimin e rekomandimeve

Kryetari i Radhës (KR). Kryetari i Radhës i OSBE-së, një post që mbahet për një vit kalendarik nga shteti pjesëmarrës i OSBE-së, i caktuar me vendim të Këshillit Ministror dhe që ushtrohet nga Ministri i Jashtëm i atij shteti, mund të ngrejë çështje që lidhen me zbatimin e rekomandimeve për zgjedhjet, gjatë takimeve me delegacionet e shteteve pjesëmarrëse në Vjenë dhe gjatë vizitave në shtetet pjesëmarrëse. Kryetari i Radhës mund të zhvillojë diskutime me palët e interesuara në zgjedhje, përfshirë dhe organet e administrimit të zgjedhjeve, partitë politike, organizatat e shoqërisë civile dhe përfaqësuesit e medias, dhe të bëjë deklaratat publike për të nxitur zbatimin e rekomandimeve të ODIHR-it.

Këshilli i Përhershëm (KP). Këshilli i Përhershëm, ku përfaqësohen të gjitha shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së, mblidhet çdo javë në Vjenë për të diskutuar zhvillimet në rajonin e OSBE-së dhe për të marrë vendime në lidhje me to. Këto takime mund të ofrojnë mundësi për diskutimin e zhvillimit të zgjedhjeve, veçanërisht pas daljes së deklaratave paraprake dhe raporteve përfundimtare, si dhe të përpjekjeve të shteteve pjesëmarrëse për shqyrtimin e rekomandimeve. Vendimet e mëparshme të Këshillit Ministror të OSBE-së (shih Kapitullin 3) i kanë inkurajuar shtetet pjesëmarrëse dhe ODIHR-in të raportojnë në Këshillin e Përhershëm mbi zbatimin e rekomandimeve për zgjedhjet.

Komiteti i Dimensionit Njerëzor (KiDNJ). KiDNJ-ja përbëhet nga përfaqësues të shteteve pjesëmarrëse dhe diskuton çështje të dimensionit njerëzor, përfshirë edhe përmbushjen e angazhimeve, duke krijuar mundësinë për shkëmbim informacioni midis institucioneve të OSBE-së, misionëve të saj në terren dhe shteteve pjesëmarrëse. Këtu janë përfshirë shpesh edhe raportime të shteteve pjesëmarrëse, me nismën e tyre, mbi përmbushjen e angazhimeve që lidhen me zgjedhjet dhe mbi ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të ODIHR-it. Kjo u ofron shteteve pjesëmarrëse një mekanizëm "të zbutur" vlerësimi paralel mes tyre.

Takimi për zbatimin e dimensionit njerëzor (TZDNJ). TZDNJ-ja, konferenca më e madhe e përvitshme e Evropës për të drejtat e njeriut, e organizuar nga ODIHR-i në Varshavë, mbledh zyrtarë qeverish, ekspertë ndërkombëtarë dhe përfaqësues të shoqërisë civile, për të marrë në shqyrtim ecurisë së shteteve të ndryshme sa u përket angazhimeve të tyre në dimensionin njerëzor. Këtu mund të përfshihet zbatimi i rekomandimeve për zgjedhjet dhe i përpjekjeve për harmonizimin e kuadrit të tyre ligjor dhe mënyrën se si i zhvillojnë zgjedhjet, me angazhimet e OSBE-së dhe me detyrime të tjera ndërkombëtare.

Seminaret për dimensionin njerëzor (SDNJ). SDNJ-të ofrojnë një platformë për shkëmbim pikëpamjesh në lidhje me çështje të dimensionit njerëzor mes shteteve pjesëmarrëse, strukturave ekzekutive, organizatave ndërkombëtare, organizatave të shoqërisë civile dhe aktorëve të tjerë. Në disa raste, SDNJ-të kanë shërbyer si forum për diskutimin e çështjeve që lidhen me zbatimin e rekomandimeve të ODIHR-it për zgjedhjet.

Komisioneri i Lartë për Pakicat Kombëtare (KLPK). KLPK-ja vepron në situata tensioni, që përfshijnë pakica kombëtare e që mund të shndërrohen në konflikte, duke u përpjekur të identifikojë dhe të shqyrtojë si shtytësit afatshkurtër të tensioneve apo konflikteve etnike, ashtu edhe shqetësimet strukturore afatgjata. Nëse një shtet pjesëmarrës nuk i përmbush angazhimet apo detyrimet e tij në fushën e pakicave kombëtare, KLPK-ja ndihmon me ofrim analizash dhe rekomandimesh. KLPK-ja ofron edhe mbështetje strukturore përmes projekteve të vogla bashkëpunuese, që synojnë arritjen e qëndrueshmërisë përmes rritjes së sensit të autorësisë vendase të procesit. Në të dyja këto fusha mund të përfshihet ndjekja e ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të ODIHR-it për zgjedhjet. Përveç kësaj, KLPK-ja dërgon shpesh edhe ekspertë për pakicat kombëtare në misionet e ODIHR-it për vëzhgimin e zgjedhjeve. Këta ekspertë kontribuojnë në raportimet e misionit, gjë që mund të lehtësojë ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve që lidhen posaçërisht me pakicat kombëtare në periudhat paszgjedhore.

Përfaqësuesi për Lirinë e Medias (PLM). PLM-ja vëzhgon zhvillimet e medias dhe i ndihmon shtetet pjesëmarrëse t'u përmbahen angazhimeve të tyre në fushën e lirisë së shprehjes dhe medias së lirë. Këtu përfshihen përpjekjet për garantimin e sigurisë së gazetarëve; ndihmesa për zhvillimin e pluralizmit mediatik; nxitja e dekriminalizimit të shpifjes; lufta ndaj gjuhës së urrejtjes duke

ruajtur në të njëjtën kohë lirinë e shprehjes; ofrimi i opinioneve të ekspertëve për rregullimin dhe legjislacionin mbi median; si dhe nxitja e lirisë së internetit. Gjithashtu, PLM-ja mban konferenca rajonale të medias, ku marrin pjesë gazetarë, përfaqësues të shoqërisë civile, akademikë dhe zyrtarë qeverish për të diskutuar çështje të lirisë së medias. Të gjitha këto fusha mund të përfshijnë fokusimin te ndjekja e zbatimit të rekomandimeve të ODIHR-it për zgjedhjet.

Misionet në terren (MT). Misionet në terren dërgohen me ftesë të vendit pritës dhe mandatet e tyre miratohen me konsensusin e shteteve pjesëmarrëse. Në varësi të mandatit që u jepet, MT-të e OSBE-së i japin mundësi organizatës të trajtojë krizat në momentin që ato shfaqen, dhe të luajë një rol shumë të rëndësishëm në periudhat pas konflikteve, duke ndihmuar në rivendosjen e besimit mes komuniteteve të prekura prej tyre. Më gjerësisht, ato mund të rrisin kapacitetin e vendeve pritëse përmes projektsh konkrete, që u përgjigjen nevojave të shteteve pjesëmarrëse. Këto mund të përfshijnë nismat për mbështetjen e organeve të administrimit të zgjedhjeve, organeve të zbatimit të ligjit, të drejtave të pakicave kombëtare, pjesëmarrjes së grave, programeve të edukimit qytetar, reformave ligjore, sundimit të ligjit dhe lirisë së medias. Në vendet ku janë të pranishme, MT-të mund të ofrojnë mundësinë e ndërthurjes së ekspertizës së ODIHR-it në fushën e zgjedhjeve me mandatin, praninë dhe përvojën e MT-së në vendin përkatës, për të ofruar asistencë afatgjatë në mbështetje të zbatimit të rekomandimeve. Disa MT kanë zhvilluar projekte në mbështetje të reformës zgjedhore, në bashkëpunim me ODIHR-in, dhe ODIHR-i u ofron shpesh, ekspertizë të drejtpërdrejtë teknike, këtyre projekteve. MT-të dhe ODIHR-i mbajnë lidhje të ngushta në të gjitha fazat e ciklit zgjedhor.

Asambleja Parlamentare e OSBE-së (AP). Asambleja Parlamentare e OSBE-së mbledh më shumë se 300 ligjbërës nga parlamentet e shteteve pjesëmarrëse të OSBE-së për të lehtësuar dialogun dhe bashkëpunimin, si dhe për të nxitur llogaridhënien. Parlamentarët e OSBE-së marrin pjesë shpesh, edhe në aktivitete të vëzhgimit të zgjedhjeve, kryejnë vizita në vende të ndryshme dhe kryesojnë reforma organizative. Asambleja Parlamentare e OSBE-së mund të ndihmojë në rritjen e ndërgjegjësimit mbi rekomandimet e ODIHR-it për zgjedhjet dhe në nxitjen e zbatimit të tyre, sidomos përmes homologëve të tyre parlamentarë në shtetet pjesëmarrëse përkatëse.

7.3 Bashkërendimi mes organizatave ndërkombëtare

ODIHR-i bashkërendon aktivitetet e tij në ndjekje të zbatimit të rekomandimeve, së bashku me vëzhguesit e tjerë ndërkombëtarë të zgjedhjeve, në kuadër të Deklaratës së Parimeve për Vëzhgimin Ndërkombëtar të Zgjedhjeve (DP), si dhe me një gamë më të gjerë organizatash ndërkombëtare.

Vëzhguesit ndërkombëtarë të zgjedhjeve. Vitet e fundit është rritur ndjeshëm bashkërendimi mes organizatave që kanë përqafuar Deklaratën e Parimeve.

Raportet e vëzhgimit të zgjedhjeve shkëmbehen tashmë në mënyrë sistematike mes anëtarëve të DP-së dhe ka një bashkërendim gjithmonë e më të madh – si në nivel të selive drejtuese, ashtu edhe në shkallë vendi – mbi çështjet kryesore të vëzhgimit, rekomandimeve për zgjedhjet dhe zbatimit të tyre. Në të gjithë komunitetin e DP-së, pranohet gjerësisht se zbatimi i rekomandimeve për zgjedhjet ka përparësi. Një sërë hapash janë ndërmarrë nga komuniteti i DP-së për rritjen e bashkërendimit në mbështetje të zbatimit të rekomandimeve për zgjedhjet. Këtu përfshihen diskutimet mbi mënyrën se si mund të planifikohet, të ndiqet dhe të organizohet në mënyrë strategjike, zbatimi i rekomandimeve në vende të veçanta; takimet mes mbështetësve të DP-së gjatë aktiviteteve të vëzhgimit të zgjedhjeve dhe vizitave për vlerësimin e ecurisë së tyre; si dhe vëmendja e vazhdueshme ndaj kësaj çështjeje në takimet e përvitshme të DP-së sa i takon zbatimin. Komuniteti i DP-së, gjithashtu, ka bashkëpunuar për t'i nxitur shtetet të raportojnë mbi zbatimin e rekomandimeve për zgjedhjet, përmes mekanizmave universale dhe atyre rajonale.

Organizatave ndërkombëtare Bashkërendimi i dhënies së mesazheve politike me organizatat e tjera ndërqeveritare për zhvillimin e zgjedhjeve është një praktikë e konsoliduar e ODIHR-it, si rrjedhojë e së cilës deklaratat pas zgjedhjeve bëhen shpesh së bashku me delegacionet parlamentare të OSBE-së, Këshillit të Evropës, Parlamentit Evropian dhe, ndonjëherë, edhe NATO-s. Këto dhe organizatat e tjera ndërkombëtare mund të luajnë rol kyç në nxitjen e zbatimit të rekomandimeve të ODIHR-it për zgjedhjet. Gjatë aktiviteteve të tij zgjedhore, ODIHR-i mund të tërheqë shpesh vëmendjen ndaj raporteve dhe rekomandimeve të organizatave të tjera ndërkombëtare, si pjesë të vlerësimeve të tij të përgjithshme.

• **Kombet e Bashkuara**

Organizata e Kombeve të Bashkuara përbën një nga partnerët më të afërt të OSBE-së, me të cilën ajo bashkëpunon sipas Kuadrit për Bashkëpunimin dhe Bashkërendimin mes Sekretariatit të OKB-së dhe OSBE-së, të vitit 1993. Në po të njëjtin vit, OKB-ja i dha OSBE-së statusin e vëzhguesit. ODIHR-i punon ngushtësisht me një sërë organizmash të OKB-së për ndjekjen e ecurisë së zbatimit të rekomandimeve për zgjedhjet, sidomos me Zyrën për Asistencë Zgjedhore të Departamentit të Çështjeve Politike, Programin për Zhvillim i OKB-së (PNUD) dhe UN Women. Këtu përfshihet shqyrtimi i rekomandimeve të ODIHR-it përmes projekteve të OKB-së për asistencë zgjedhore dhe mbajtjes së tryezave të rumbullakëta dhe seminareve për çështje të veçanta. Raportet dhe rekomandimet e ODIHR-it për zgjedhjet mund të përdoren si burime të mekanizmave raportuese të OKB-së për të drejtat e njeriut, përfshirë dhe organet e traktateve dhe RPU-në.

• **Këshilli i Evropës**

Këshilli i Evropës dhe OSBE-ja kanë të njëjtin qëllim: nxitjen e stabilitetit në Evropë, bazuar te demokracia, sundimi i ligjit dhe respektimi i të drejtave të njeriut. Bashkëpunimi mes dy organizatave parashikohet në Katalogun e Përbashkët për Modalitetet e Bashkëpunimit, të vitit 2000, nënshkruar nga

Sekretarët e Përgjithshëm përkatës. ODIHR-i ka një marrëveshje të posaçme për partneritet me Këshillin e Evropës për bashkërendimin e punës për të drejtat e njeriut, përfshirë edhe aktivitetet zgjedhore. Këshilli po përfshihet gjithmonë e më shumë në ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve për zgjedhjet dhe në reformat më të gjera zgjedhore, përfshirë edhe asistencën teknike për organet e administrimit të zgjedhjeve, agjencitë e tjera që operojnë në fushën e zgjedhjeve dhe gjykatat. ODIHR-i dhe Këshilli i Evropës organizojnë shpesh tryeza të rrumbullakëta dhe seminare të përbashkëta për çështje të reformës zgjedhore, kurse në partneritet me Komisionin e Venecias të Këshillit ODIHR-i ofron opinione mbi projektligje ose ligje në fushën e zgjedhjeve.

• ***Bashkimi Evropian***

Vendet anëtare të BE-së dhe Komisioni Evropian janë ndër partnerët kryesorë të OSBE-së në financimin dhe zbatimin e projekteve për të drejtat e njeriut në të gjithë rajonin e OSBE-së. BE-ja përfaqësohet në organet e OSBE-së nga delegacioni i vendit që ka presidencën e radhës të BE-së. Që prej vitit 2009, BE-ja ka pranuar dhe ka theksuar rëndësinë e ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve për zgjedhjet. Në Planin e saj të Veprimit për të Drejtat e Njeriut dhe Demokraci, të vitit 2015, BE-ja rikonfirmoi mbështetjen e saj për DP-në dhe vullnetin e saj për të punuar ngushtësisht me organizata të tjera ndërkombëtare, që u përmbahen të njëjtave parime, sidomos me ODIHR-in. Rekomandimet e ODIHR-it për zgjedhjet citohen shpesh në deklaratat e BE-së në Këshillin e Përhershëm të OSBE-së dhe në aktivitete të tjera, si dhe në dokumentet politike dhe instrumentet financiare të BE-së. BE-ja është angazhuar për të ndjekur ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të ODIHR-it për zgjedhjet, përfshirë edhe integrimin e atyre rekomandimeve në dialogun politik dhe aktivitetet mbështetëse të BE-së dhe vendeve anëtare të BE-së.

• ***Organizatat e tjera ndërkombëtare***

ODIHR-i është i hapur ndaj bashkëpunimit me organizatat e tjera ndërkombëtare, të angazhuara për të ndihmuar në ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve për zgjedhjet. Kjo përbën një vlerë veçanërisht të shtuar për organizatat, vendet anëtare të cilave janë edhe shtete pjesëmarrëse të OSBE-së, përfshirë dhe Komonuelthin e Shteteve të Pavarura, Organizatën e Shteteve Amerikane dhe Institutin Ndërkombëtar për Demokraci dhe Asistencë Zgjedhore.

• ***NATO***

Marrëdhëniet midis NATO-s dhe OSBE-së janë zhvilluar në mënyrë pragmatike që të përfshijnë si dialogun politik, ashtu edhe ndërveprimin operacional në terren. NATO mund të nxisë dhe të punojë për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të ODIHR-it për zgjedhjet, sidomos kur këto rekomandime lidhen me çështje të sigurisë.

7.4 Bashkërendimi me komunitetin e donatorëve dhe atë diplomatik

Organizatat ndërkombëtare donatore dhe anëtarët e komunitetit diplomatik në një shtet duhet të luajnë një rol kyç në mbështetje të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve për zgjedhjet.

Komuniteti i donatorëve Partnerët ndërkombëtarë për zhvillim i mbështesin shpesh proceset zgjedhore përmes asistencës teknike, e cila jepet zakonisht nga "partnerët për zbatim". Kjo mund të jetë ndonjëherë e vështirë, sidomos kur ka presion për të mbështetur mbajtjen operacionale të zgjedhjeve brenda një kohe shumë të shkurtër, në vend që të kërkohet mbështetje për shqyrtimin e zhvillimit afatgjatë të kapaciteteve. Pra, partnerët ndërkombëtarë për zhvillim mund të jenë shumë efektshëm në mbështetjen e zbatimit të rekomandimeve përmes ndjekjes së qasjen sipas ciklit zgjedhor, përdorimit të standardeve bazë dhe nxitjes për ndryshim.

Qasja e bazuar sipas ciklit zgjedhor përfshin vlerësimin e nevojave pas zhvillimit të zgjedhjeve, ku duhet të merren parasysh rekomandimet e përgatitura nga grupet ndërkombëtare dhe të vëzhguesve qytetarë dhe, më pas, krijimi i një programi asistence deri në zgjedhjet e radhës dhe pas tyre. Këtu mund të përfshihen disa standarde bazë, përkundrejt të cilave matet progresi i arritur, i cili mbështetet në rekomandimet për zgjedhjet. Partnerët ndërkombëtarë për zhvillim mund të ofrojnë edhe stimuj dhe nxitje për zbatimin e rekomandimeve, duke vënë në dukje se mbështetja në vazhdim varet nga progresi i arritur. Rishikimet afatmesme nga donatorët mund të jenë mjete të dobishme për vlerësimin e progresit të arritur dhe për rikalibrimin e mbështetjes programatike dhe për dhënien e mesazheve politike.

Komuniteti diplomatik. Komuniteti diplomatik në vend mund të nxisë vëmendjen ndaj zbatimit të rekomandimeve për zgjedhjet dhe të inkurajojë përfshirjen e tij në axhendën politike të vendit përkatës. Dhënia e mesazheve të bashkërenduara rreth rëndësisë së përmirësimit të zhvillimit të zgjedhjeve, në përputhje me angazhimet dhe detyrimet ndërkombëtare, si dhe vëmendja ndaj çështjeve të veçanta, rrit mundësinë e ndërmarrjes së hapave pozitive për zbatimin e rekomandimeve. Komuniteti diplomatik mund të inkurajojë edhe raportimin në Këshillin e Përhershëm dhe në KiDNJ, si dhe në mekanizma të të drejtave të njeriut për të nxitur llogaridhënien e shteteve përkatëse dhe respektimin e instrumenteve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut. ODIHR-i mund të nxisë dhënien e mesazheve të tilla politike përmes ofrimit sistematik të informacioneve rreth zbatimit të rekomandimeve dhe aktiviteteve për ndjekjen e ecurisë së këtij procesi.



8. Vlerësimi i ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve për zgjedhjet

Vlerësimi i ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve është i rëndësishëm në disa faza të ciklit zgjedhor. Në periudhën para zgjedhjeve, kjo është një nga gjërat kryesore që merr parasysh misioni i vlerësimit të nevojave i ODIHR-it, kur rekomandon nëse duhet ndërmarrë një aktivitet për vëzhgimin e zgjedhjeve. Në periudhën zgjedhore, shkalla e zbatimit të rekomandimeve të mëparshme kontribuon në vlerësimin përfundimtar të zgjedhjeve nga misioni i vëzhgimit. Pas zgjedhjeve, rishikimi i rekomandimeve mund të ndihmojë për të kuptuar sfidat e vazhdueshme zgjedhore dhe nivelin e interesit ndaj reformës së ardhshme zgjedhore.

Vlerësimi i zbatimit të rekomandimeve kërkon një shqyrtim dhe gjykim të kujdesshëm, sidomos për shkak se disa faza të procesit zgjedhor ende mund të mos jenë zhvilluar. Për të garantuar vijueshmërinë dhe një vlerësim të plotë, mund të merren parasysh treguesit e renditur më poshtë. Përveç ODIHR-it, analiza të zbatimit të rekomandimeve mund të ndërmerren edhe nga autoritetet e shteteve pjesëmarrëse, shoqëria civile, media, donatorët ndërkombëtarë dhe aktorë të tjerë ndërkombëtarë.

- 1. Identifikimi i rekomandimeve që duhet të vlerësohen.** Zakonisht, rekomandimet janë nga zgjedhjet më të fundit, që janë vëzhguar, por mund të përfshijnë edhe rekomandime nga zgjedhje të tjera para tyre. Për shembull, për zgjedhjet vendore, mund të jetë e dobishme të analizohen jo vetëm rekomandimet e dhëna nga zgjedhjet më të fundit parlamentare, por edhe nga zgjedhjet e fundit vendore, që janë vëzhguar. I dobishëm mund të jetë edhe shqyrtimi i rekomandimeve të misioneve të tjera ndërkombëtare dhe të grupeve të vëzhguesve qytetarë, nëse ato janë të besueshme dhe, sidomos, nëse ato përfshijnë edhe rekomandime të tjera, që nuk janë përfshirë në raportet e ODIHR-it.
- 2. Komunikimi me një numër të madh aktorësh.** Duhet të zhvillohen diskutime me një numër të madh aktorësh rreth ndryshimeve që janë bërë në kuadrin dhe mjedisin e zgjedhjeve. Këtu duhet të përfshihen takimet me përfaqësues të autoriteteve shtetërore dhe zgjedhore, partive politike, organeve të medias, organizatave të shoqërisë civile dhe grupeve të papërfaqësuara sa duhet politikisht. Diskutimet duhet të mbulojnë edhe nismat për reformë zgjedhore, që mund të mos përbëjnë një reagim të drejtpërdrejtë ndaj rekomandimeve të ODIHR-it.
- 3. Shqyrtimi i shkallës së zbatimit të secilit rekomandim.** Shkalla e zbatimit të rekomandimeve duhet të shihet përgjithësisht, në faza të ndryshme, përfshirë rekomandimet e zbatuara plotësisht, pjesërisht dhe ato që nuk janë zbatuar fare. Jo gjithmonë mund të bëhet një vlerësim përfundimtar; kjo mund të vijë për shkak se ajo fazë e procesit, në të cilin duhet të zbatohet një rekomandim i caktuar, ende mund të mos ketë filluar ose mund të ketë filluar e të mos jetë ende në fazën që mund të vlerësohet. Në disa raste, një rekomandim mund t'i ketë ikur koha për shkak të zhvillimeve të tjera, më të gjera politike. Ndonëse, nga njëra anë, duhet mbajtur parasysh angazhimi i shtetit pjesëmarrës për të zbatuar rekomandimet e ODIHR-t për zgjedhjet, çdo rekomandim që një shtet nuk e konsideron me vend apo që i duket i vështirë për t'u zbatuar, duhet të diskutohet me kujdes me autoritetet dhe duhet parë me vëmendje çdo faktor i besueshëm zbutës që ka sjellë moszbatimin.
- 4. Njohja e situatës së përgjithshme.** Vëmendje i duhet kushtuar kontekstit, në të cilin bëhet vlerësimi. Këtu përfshihet situata politike dhe e sigurisë së shtetit pjesëmarrës, zhvillimi i zgjedhjeve që nga bërja e rekomandimeve, zhvillimet e reja në fushën e zgjedhjeve, që nuk janë përfshirë nga rekomandimet dhe çdo proces reforme që ndodh ndërkohë. Këtu përfshihet edhe identifikimi i rekomandimeve që janë zbatuar dhe nëse ato rekomandime kanë qenë prioritare; nëse përfshinin ndryshime ligjore dhe cilat institucione/organizata kanë qenë përgjegjëse për zbatimin e tyre; nëse procesi ka qenë gjithëpërfshirës dhe i ndërmarrë në mirëbesim;

nëse rekomandimet janë zbatuar mjaftueshëm në kohë para zgjedhjeve dhe nëse janë shoqëruar me informimin e mjaftueshëm të zgjedhësve dhe trajnimin e mjaftueshëm të personelit që administrojnë zgjedhjet. E rëndësishme është gjithashtu, se si palët e interesuara në zgjedhje e perceptojnë rëndësinë e rekomandimeve të zbatuara, nëse zbatimi i tyre krijon besim në zgjedhjet e radhës dhe çdo çështje të mbetur pa zgjidhur dhe që rrezikon procesin zgjedhor. Ndonëse në vlerësimin e zbatimit të rekomandimeve duhet të merret në shqyrtim gjithëpërfshirja e rekomandimeve të shqyrtuara, në të duhet t'i kushtohet vëmendje të veçantë edhe ndikimit thelbësor dhe të akumuluar të të gjitha ndryshimeve në tërësi

Duke qenë se nuk është gjithmonë e mundur që të bëhen vlerësime të prera mbi zbatimin e rekomandimeve, shqyrtimi i tyre duhet të ketë më shumë natyrë përshkruese dhe jo përfundimtare. Gjithashtu, ky shqyrtim duhet të fokusohet te rekomandimet prioritare dhe tek ato që, nëse nuk zbatohen, mund të përbëjnë rrezikun më të madh për proceset e ardhshme zgjedhore.



9. Nxitja e pjesëmarrjes së grupeve të papërfaqësuar sa duhet politikisht

Angazhime të ndryshme të OSBE-së dhe detyrime ndërkombëtare përfshijnë garantimin e mosdiskriminimit dhe nxitjen e pjesëmarrjes gjithëpërfshirëse në jetën politike dhe publike. Kjo duhet të reflektohet në zbatimin e rekomandimeve për zgjedhjet nga shtetet pjesëmarrëse. ODIHR-i bën përpjekje sistematike për t'u siguruar që aktivitetet për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të jenë të ndjeshme ndaj pjesëmarrjes së grupeve të papërfaqësuar sa duhet politikisht

9.1 Angazhimet e OSBE-së dhe detyrimet ndërkombëtare që nxisin pjesëmarrjen e grupeve të papërfaqësuar sa duhet politikisht

Grupet e papërfaqësuar sa duhet politikisht mund të karakterizohen si njerëzit që, përgjithësisht ose historikisht, janë anashkalluar gjatë proceseve politike. Instrumente të ndryshme ndërkombëtare dhe rajonale të të drejtave të njeriut parashikojnë mbrojtjen dhe nxitjen e të drejtave të grupeve të

tilla, ku instrumente të veçanta parashikojnë pjesëmarrjen e grave, pakicave kombëtare dhe personave me aftësi të kufizuara.

Gratë

Angazhimet e OSBE-së dhe detyrimet e tjera ndërkombëtare e bëjnë të qartë që burrat dhe gratë duhet të gëzojnë të drejta të barabarta gjatë gjithë procesit zgjedhor. Këtu përfshihet Vendimi i Këshillit Ministror të OSBE-së për Pjesëmarrjen e Grave në Jetën Politike dhe Publike, i vitit 2009, i cili i angazhon shtetet pjesëmarrëse të "konsiderojnë marrjen e masave të mundshme legjislative, që do të bënin më të lehtë një pjesëmarrje më të ekuilibruar të grave dhe burrave në jetën politike dhe publike dhe sidomos në vendimmarrje".⁸ Kjo mbështetet në KEDNG-në, e cila i referohet shprehimisht garantimit të së drejtës së "pjesëmarrjes në hartimin e politikave qeveritare dhe zbatimit të tyre" në kushte të barabarta si për burrat, ashtu edhe për gratë. Kjo është shtjelluar në interpretimet zyrtare të komitetit të KEDNG-së, sidomos në Rekomandimin e Përgjithshëm nr. 23 për pjesëmarrjen politike, i cili njeh nevojën për marrjen parasysh të pikëpamjeve të grupeve të grave në politikëbërje dhe vlerën e të dhënave statistikore, të ndara sipas gjinisë, për të ndihmuar në hartimin e politikave që vënë në jetë të drejtat e parashikuara nga kjo konventë.

Pakicat kombëtare

Një sërë angazhimesh të OSBE-së dhe instrumentesh të tjera ndërkombëtare njohin të drejtën e pakicave kombëtare për të marrë pjesë në çështjet publike pa u diskriminuar, përfshirë edhe të drejtën e përdorimit të gjuhës së tyre. Ndër angazhimet e OSBE-së, paragrafi 35 i Dokumentit të Kopenhagenit të OSBE-së, të vitit 1990, në veçanti, i angazhon shtetet pjesëmarrëse që të nxisin të drejtën e personave që u përkasin pakicave për të marrë pjesë në mënyrë të efektshme në çështjet publike. Kjo mbështetet në nenin 5 të KNEFDR-së, i cili i detyron shtetet të marrin masat që të gjithë shtetasit të mund "të marrin pjesë si në qeveri, ashtu edhe në drejtimin e çështjeve publike në çdo nivel", pa dallim race, ngjyre, kombësie apo origjine etnike. Kjo rikonfirmohet në Rekomandimin e Përgjithshëm nr. 32 të KEDR-së, i cili thekson nevojën për konsultime paraprake dhe për pjesëmarrjen aktive të këtyre komuniteteve kur bëhen ndryshime të kuadrit ligjor. Rekomandimi i Përgjithshëm nr. 32 thekson edhe nevojën për ndarjen e të dhënave sipas racës, ngjyrës, prejardhjes, etnisë dhe kombësisë për të krijuar mundësi për hartimin e politikave që do të çonin në zbatimin e efektshëm të KNEFDR-së. Rekomandimi i Përgjithshëm nr. 27 i KEDR-së i referohet veçanërisht përfshirjes së komuniteteve romë në hartimin dhe zbatimin e politikave që synojnë nxitjen e pjesëmarrjes së tyre.

⁸ Shih edhe paragrafin 40 të Dokumentit të Moskës të OSBE-së, të vitit 1991, i cili i angazhon shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së të marrin një sërë masash për të rritur pjesëmarrjen e grave, dhe paragrafin 23 të Dokumentit të Stambollit të OSBE-së, të vitit 1999, i cili i angazhon shtetet pjesëmarrëse të garantojnë barazinë gjinore në politikëbërje.

Personat me aftësi të kufizuara

Në paragrafin 41 të Dokumentit të Moskës të OSBE-së, të vitit 1991, shtetet pjesëmarrëse u zotuan "të garantojnë mbrojtjen e të drejtave të njeriut të personave me aftësi të kufizuara", përfshirë dhe pjesëmarrjen në vendimmarrje. Në nivel universal, KEDR-ja përmban dispozita të qarta për pjesëmarrjen e barabartë politike të personave me aftësi të kufizuara. Neni 4.3 u kërkon shteteve "të konsultohen ngushtësisht me personat me aftësi të kufizuara dhe t'i përfshijnë ata në mënyrë aktive" në hartimin dhe realizimin e masave në zbatim të KEDR-së. Neni 31 kërkon kategorizimin e të dhënave për t'u dhënë mundësi autoriteteve të formulojnë dhe të zbatojnë politika që vënë në jetë KEDR-në.

9.2 Nxitja e pjesëmarrjes së grupeve të papërfaqësuar sa duhet politikisht në proceset e zbatimit të rekomandimeve dhe në reforma

Ata që marrin përsipër zhvillimin e aktiviteteve për zbatimin e rekomandimeve për zgjedhjet duhet të shohin nëse procesi dhe rezultatet e reformës zgjedhore do ta nxisin apo do ta frenojnë pjesëmarrjen në zgjedhje të grupeve të papërfaqësuar sa duhet politikisht. Aktivitetet duhet (1) të përfshijnë mekanizma që u lejojnë grupeve të papërfaqësuar sa duhet politikisht të marrin pjesë në mënyrë kuptimplote në vendimmarrjen e proceseve për zbatimin e rekomandimeve, dhe 2) të shfrytëzojnë ose të mbrojnë idenë e ofrimit të të dhënave të kategorizuara për të mundësuar hartimin e politikave pas një procesi informimi.

Së pari, përfshirja në proces e grupeve të papërfaqësuar sa duhet politikisht duhet të jetë kuptimplote dhe jo sipërfaqësore. Kjo përfshin punën me grupet që janë gjerësisht përfaqësuese, duke ofruar informacion paraprakisht, në mënyrë që çështjet dhe zgjedhjet të kuptohen mirë dhe të jepet mundësi për pyetje dhe sugjerime. Konsultime të tilla duhet të mbahen sistematikisht dhe jo një herë të vetme dhe duhet të dokumentohen publikisht. Mund të mendohet edhe marrja e disa masave të veçanta për t'u garantuar akses grupeve të papërfaqësuar sa duhet politikisht, përfshirë edhe ofrimin e materialeve në gjuhët e pakicave ose duke garantuar mbajtjen e takimeve të hapura për personat me aftësi të kufizuara fizike ose shqisore. Përfaqësuesit e grupeve të papërfaqësuar sa duhet politikisht duhet të përfshihen edhe në vlerësimin e zbatimit të rekomandimeve dhe efektshmërisë së çdo reforme të zbatuar më parë. Këtu përfshihen reformat që synojnë rritjen e pjesëmarrjes së grupeve të papërfaqësuar sa duhet – për shembull, përmes masave të posaçme të përkohshme – si dhe reformat me natyrë më të përgjithshme.

Së dyti, përdorimi i të dhënave të ndara mbi pjesëmarrjen në zgjedhje të grupeve të anashkaluara mund të ndihmojë në vlerësimin e masave ekzistuese dhe diskutimin e reformave që mund të ndërmerren për të nxitur më shumë pjesëmarrjen e tyre. Në çdo rast, është e rëndësishme të respektohen standardet e mbrojtjes së të dhënave në mbledhjen dhe trajtimin e këtij informacioni. Nëse nuk disponohen të dhëna të ndara, në kuadër të aktiviteteve për zbatimin e rekomandimeve duhet të shihet mundësia e ngritjes së mekanizmave të tillë për të vlerësuar efektshmërinë e reformave dhe shkallën e përmbushjes së angazhimeve të OSBE-së dhe detyrimeve ndërkombëtare. Teorikisht, të dhënat e kategorizuara duhet të përfshijnë edhe organet e administrimit të zgjedhjeve dhe institucione të tjera, të përfshira në zgjedhje, si dhe partitë politike dhe shoqërinë civile.

Përfshirja e grupeve të papërfaqësuar sa duhet politikisht në aktivitetet për zbatimin e rekomandimeve dhe monitorimi i ndikimit që ka pjesëmarrja e tyre përmes të dhënave të kategorizuara, përbën një parakusht thelbësor për nxitjen e pjesëmarrjes së efektshme të të gjithë shtetasve në proceset zgjedhore.

Shtojcat

SHTOJCA A

Angazhimet e OSBE-së dhe detyrimet e standardet e tjera ndërkombëtare për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve për zgjedhjet

OSBE

Akti Final i Helsinkit, i vitit 1975

(...) Në fushën e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, shtetet anëtare do të veprojnë në përputhje me qëllimet dhe parimet e Kartës së Kombeve të Bashkuara dhe të Deklaratës Universale të së Drejtave të Njeriut. Ato do të përmbushin edhe detyrimet e përcaktuara në deklaratat dhe marrëveshjet ndërkombëtare në këtë fushë, përfshirë, ndër të tjera, Paktet Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut, të cilat janë detyruese për to.

Dokumenti i Madridit, i vitit 1983

Shtetet pjesëmarrëse (...) ripohojnë rëndësinë e veçantë të Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut, Pakteve Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut dhe instrumenteve të tjera ndërkombëtare përkatëse të përpjekjeve të tyre të përbashkëta dhe individuale për nxitjen dhe zhvillimin e respektimit të përgjithshëm të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore; ato u bëjnë thirrje të gjitha shteteve pjesëmarrëse të veprojnë në përputhje me këto instrumente ndërkombëtare dhe atyre shteteve pjesëmarrëse që ende nuk janë pjesë, të shqyrtojnë mundësinë e aderimit në këto pakte.

Dokumenti i Kopenhagenit, i vitit 1990

(5) [Shtetet anëtare] deklarojnë solemnisht se, ndër ato elemente të drejtësisë, që janë thelbësore për shprehjen e plotë të dinjitetit të qenësishëm dhe të të drejtave të barabarta e të patjetërsueshme të të gjitha qenieve njerëzore, janë këto:

(5.7) – të drejtat të njeriut dhe liritë themelore garantohen me ligj dhe në përputhje me detyrimet e tyre, në bazë së të drejtës ndërkombëtare;

(5.8) – legjislacioni që miratohet në fund të një procedure publike, dhe rregulloret publikohen, kusht ky për zbatueshmërinë e tyre. Tekstet e tyre vihen në dispozicion të të gjithëve; (...)

(7.1) – do të mbajnë zgjedhje të lira, në intervale të arsyeshme, siç parashikohet në ligj;

Dokumenti i Parisit, i vitit 1990: Karta e Parisit për një Evropë të re

(1) Funkzioni i [ODIHR-it] do të jetë lehtësimi i kontakteve dhe shkëmbimit të informacionit për zgjedhjet brenda shteteve pjesëmarrëse. Kështu, Zyra do të nxisë zbatimin e paragrafëve 6, 7 dhe 8 të Dokumentit të Takimit të Kopenhagenit (...)

Dokumenti i Moskës, i vitit 1991

Shtetet pjesëmarrëse theksojnë se çështjet që lidhen me të drejtat e njeriut, liritë themelore, demokracinë dhe sundimin e ligjit janë shqetësim ndërkombëtar, pasi respektimi i këtyre të drejtave dhe lirive përbën një nga themelet e rendit ndërkombëtar. Ato deklarojnë në mënyrë të prerë dhe të përvokueshme se angazhimet e ndërmarra në fushën e dimensionit njerëzor të KSBE-së janë çështje me interes të drejtpërdrejtë dhe legjitim të të gjitha shteteve pjesëmarrëse dhe nuk u përkasin vetëm punëve të brendshme të shtetit përkatës. Ato shprehin vendosmërinë e tyre për të përmbushur të gjitha angazhimet e tyre të dimensionit njerëzor dhe për të zgjidhur me mjete paqësore çdo çështje përkatëse, individualisht dhe kolektivisht, në bazë të respektit reciprok dhe bashkëpunimit. Në këtë kontekst, ata e kuptojnë se përfshirja aktive e personave, grupeve, organizatave dhe institucioneve është thelbësore për të siguruar progres të vazhdueshëm në këtë drejtim. (...)

(18.1) Legjislacioni do të hartohet dhe miratohet si rezultat i një procesi të hapur, që pasqyron vullnetin e popullit, qoftë në mënyrë të drejtpërdrejtë qoftë përmes përfaqësuesve të tyre të zgjedhur.(...)

Dokumenti i Oslos, i vitit 1998

Shtojca 2: Kuadri bazë i Kartës për Sigurinë Evropiane, Rreziqet dhe Sfidat e Reja ndaj Sigurisë – DimENSIONI Njerëzor, Zgjedhjet

(4) Shtetet anëtare duhet të zbatojnë pa ngurrim rekomandimet e bëra nga ODIHR-i pas zgjedhjeve. ODIHR-i duhet t'i ofrojë shtetit përkatës ndihmën e tij në zbatimin e atyre rekomandimeve dhe duhet të raportojë në Këshillin e Përhershëm për ecurinë e zbatimit të tyre.

Dokumenti i Stambollit, i vitit 1999

25. Ne riafirmojnë detyrimin tonë për të zhvilluar zgjedhje të lira dhe të drejta në përputhje me angazhimet e OSBE-së, në veçanti me Dokumentin e Kopenhagenit, të vitit 1990. Ne çmojmë asistencën që ODIHR-i mund t'u japë shteteve pjesëmarrëse në hartimin dhe zbatimin e legjislacionit për zgjedhjet. Në përputhje me këto angazhime, ne do të ftojme për zgjedhjet tona vëzhgues nga shtete të tjera pjesëmarrëse, ODIHR-i, Asambleja Parlamentare e OSBE-së dhe institucionet dhe organizatat e duhura, që dëshirojnë të vëzhgojnë proceset zgjedhore. Ne biem dakord që të ndjekim menjëherë vlerësimin dhe rekomandimet e ODIHR-it për zgjedhjet.

27. Organizatat joqeveritare (OJQ-të) mund të luajnë një rol thelbësor në nxitjen e të drejtave të njeriut, demokracisë dhe sundimit të ligjit. Ato janë pjesë integrale e një shoqërie civile të fortë. Ne zotohemi që të përmirësojmë aftësitë e OJQ-ve për të dhënë kontributin e tyre të plotë për zhvillimin e mëtejshëm të shoqërisë civile dhe respektimin e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore.

Dokumenti i Portos, i vitit 2002 (Këshilli i Ministrave)

Vendimi nr.7, Angazhimet Zgjedhore

Këshilli i Ministrave, (...) Riafirmon vendosmërinë për zbatimin e këtyre angazhimeve, (...) Njeh ekspertizën e ODIHR-it në ndihmën e dhënë shteteve pjesëmarrëse në zbatimin e angazhimeve të lidhura me zgjedhjet, (...) U bën thirrje shteteve pjesëmarrëse të përforcojnë reagimin e tyre ndaj rekomandimeve të ODIHR-it për vëzhgimet vijuese zgjedhore (...).

Dokumenti i Mastrihtit, i vitit 2003

Vendimi nr. 5/03, Zgjedhjet

Këshilli i Ministrave, (...) e ngarkon ODIHR-in të shqyrtojë rrugët për të rritur efektshmërinë e ndihmës së tij ndaj shteteve pjesëmarrëse në zbatimin e rekomandimeve të bëra në raportet e vëzhgimeve zgjedhore të ODIHR-it, si dhe të informojë Këshillin e Përhershëm për progresin e bërë në përmbushjen e kësaj detyre (...).

Dokumenti i Brukselit, i vitit 2006

Vendimi Nr. 19/06, Fuqizimi i Efektshmërisë së OSBE-së (Seksioni 2)

Këshilli i Ministrave, (...)

(2) Njeh se ODIHR-i, në zbatimin e mandatit të tij, ka treguar aftësinë e tij për të ndihmuar shtetet pjesëmarrëse në përmbushjen e angazhimeve të tyre të dimensionit njerëzor;

(3) U kujton shteteve pjesëmarrëse se legjislacioni dhe praktikat e tyre duhet të jenë në përputhje me angazhimet e OSBE-së;

(4) Shqyrton vlerësimin për gjendjen aktuale të zbatimit të angazhimeve ekzistuese nga shtetet pjesëmarrëse dhe thekson, në veçanti, se vetë shtetet pjesëmarrëse janë përgjegjëse për zbatimin e efektshëm të angazhimeve të tyre të ndërrmarra në OSBE. Në këtë drejtim, ODIHR-i luan një rol të rëndësishëm në ndihmë të tyre;

(5) Ngarkon Këshillin e Përhershëm, duke marrë në konsideratë rekomandimet e ODIHR-it dhe institucioneve të tjera përkatëse të OSBE-së, të trajtojë sfidat e zbatimit në fushat e theksuara në raport, duke marrë parasysh që të përdorë më mirë ndihmën e ODIHR-it; (...)

(7) Njeh ekspertizën e ODIHR-it në ndihmën e dhënë ndaj shteteve pjesëmarrëse përmes veprimtarive të tij lidhur me zgjedhjet, përfshirë dhe rishikimin e legjislacionit zgjedhor dhe kryerjen e vëzhgimeve; (...)

Deklarata Përkujtimore e Astanës, e vitit 2010: Drejt një Komuniteti Sigurie

(2) Ne rikonfirmojmë zbatimin e plotë të Kartës së Kombeve të Bashkuara dhe të të gjitha normave, parimeve dhe angazhimeve të OSBE-së, duke nisur nga Akti Final i Helsinkit, Karta e Parisit, Karta për Sigurinë Evropiane dhe të gjitha dokumentet e tjera të OSBE-së që kemi nënshkruar, si dhe përgjegjësinë tonë për t'i zbatuar ato plotësisht dhe në mirëbesim. Ne rideklojmë angazhimin tonë ndaj konceptit, të nisur në Aktin Final, të sigurisë gjithëpërfshirëse, bashkëpunuese, të barabartë dhe të patjetërsueshme, e cila lidh ruajtjen e paqes me respektimin e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, dhe lidh bashkëpunimin ekonomik dhe mjedisor me marrëdhëniet paqësore ndërshtetërore.

Universale

Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, e vitit 1948

Neni 21

1. Kushdo ka të drejtë të marrë pjesë në qeverisjen e vendit të tij, drejtpërdrejt apo nëpërmjet përfaqësuesve të zgjedhur lirisht.
2. Kushdo ka të drejtë të përdorë në mënyrë të barabartë shërbimet publike në vendin e tij.
3. Vullneti i popullit është baza e autoritetit të qeverisë; ky vullnet shprehet në zgjedhje periodike dhe të vërteta, të cilat zhvillohen nëpërmjet të drejtës universale dhe të barabartë të votës dhe nëpërmjet votimit të fshehtë dhe procedurave të barasvlershme të votimit të lirë.

Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike, i vitit 1966

Neni 25

Çdo shtetas ka të drejtë dhe mundësi që, pa asnjë nga dallimet e përmendura në nenin 2 dhe pa kufizime të paarsyeshme:

- (a) të marrë pjesë në drejtimin e punëve publike, qoftë drejtpërsëdrejt ose nëpërmjet përfaqësuesve të zgjedhur lirisht;
- (b) të votojë dhe të zgjidhet gjatë zgjedhjeve të vërteta të herëpashershme, me votim të përgjithshëm dhe të barabartë dhe me vota të fshehta, të cilat sigurojnë shprehjen e lirë të vullnetit të zgjedhësve;
- (c) të pranohet, në kushte të përgjithshme barazie, për të ushtruar funksione publike në vendin e tij.

Konventa Ndërkombëtare për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racial, e vitit 1966

Neni 5

Në përputhje me detyrimet themelore të parashtruara në nenin 2 të kësaj Konvente, shtetet palë zotohen të ndalojnë dhe të eliminojnë diskriminimin racial në të gjitha format e tij dhe të garantojnë të drejtën e secilit për barazi përpara ligjit pa dallim race, ngjyre ose origjine etnike ose kombëtare, sidomos lidhur me gëzimin e këtyre të drejtave: (...)

- (c) Të drejtat politike, sidomos të drejtat e pjesëmarrjes në zgjedhje – e drejta e votimit apo e drejta për të qenë kandidat – sipas sistemit të votimit të përgjithshëm dhe të barabartë, e pjesëmarrjes në qeveri, si dhe në drejtimin e çështjeve publike, në të gjitha nivelet, dhe për të pasur akses të barabartë në shërbimet publike; (...)

Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave, e vitit 1979

Neni 7

Shtetet palë marrin të gjitha masat e përshtatshme për të eliminuar diskriminimin ndaj grave në jetën politike dhe publike të vendit dhe, në mënyrë të veçantë, u sigurojnë grave, në të njëjtat kushte me burrat, të drejtën:

- (a) Për të votuar në të gjitha zgjedhjet dhe referendumet publike, si dhe për të pasur të drejtë të zgjidhen në të gjitha organet e zgjedhura publikisht;
- (b) Për të marrë pjesë në formulimin e politikës së qeverisë dhe në zbatimin e saj; për të mbajtur poste publike dhe për të ushtruar të gjitha funksionet publike në të gjitha nivelet e qeverisjes;
- (c) Për të marrë pjesë në organizatat dhe shoqatat joqeveritare që merren me jetën publike dhe politike të vendit

Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, e vitit 2006

(4.3) Në zhvillimin dhe zbatimin e legjislacionit dhe politikave për zbatimin e kësaj Konvente, si dhe për proceset e tjera vendimmarrëse në lidhje me çështjet që kanë të bëjnë me personat me aftësi të kufizuara, shtetet palë duhet të konsultohen në mënyrë aktive me personat me aftësi të kufizuara, përfshirë këtu edhe fëmijët me aftësi të kufizuara, për të siguruar përfshirjen e tyre nëpërmjet organizatave të tyre përfaqësuese.

Komiteti për të Drejtat e Njeriut, e vitit 1996 – Komenti i Përgjithshëm nr. 25 për të drejtën e pjesëmarrjes në punët publike, të drejtën e votës dhe të drejtën për akses të barabartë në shërbimet publike

(5) Drejtimi i çështjeve publike (...) është një koncept i gjerë, i cili lidhet me ushtrimin e pushtetit politik, në veçanti me ushtrimin e pushtetit legjislativ, ekzekutiv dhe administrativ. Ky koncept parashikon të gjithë aspektet e administratës publike, si dhe hartimin dhe zbatimin e politikave në shkallë vendore, rajonale, kombëtare dhe ndërkombëtare. Ndarja e pushteteve dhe mjetet, përmes të cilave shtetasit individualë ushtrojnë të drejtën e pjesëmarrjes në drejtimin e çështjeve publike, e mbrojtur nga neni 25, duhet të përcaktohet nga kushtetuta dhe ligjet e tjera.

Deklarata e Asamblesë së Përgjithshme, e vitit 1998, për të drejtën dhe përgjegjësinë e individëve, grupeve dhe organizmave të shoqërisë për të nxitur dhe mbrojtur të drejtat të njeriut dhe liritë themelore, të njohura botërisht

- (1) Kushdo ka të drejtën, qoftë individualisht ose në bashkësi me të tjerët, të ketë qasje efektive, pa diskriminim, në pjesëmarrjen në qeverisjen e vendit të tij/saj dhe në drejtimin e çështjeve publike.

(2) Kjo përfshin, ndër të tjera, të drejtën, qoftë individualisht ose në bashkësi me të tjerët, e paraqitjes para organeve qeveritare dhe agjencive e organizatave përkatëse, të kritikave për çështjet publike dhe propozimeve për përmirësimin e funksionimit të tyre, si dhe të tërheqjes së vëmendjes ndaj çdo aspekti të punës së tyre, që mund të pengojë ose vështirësojë nxitjen, mbrojtjen dhe realizimin e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore.

Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme, e vitit 2013, për forcimin e rolit të Kombeve të Bashkuara në përmirësimin e zgjedhjeve periodike dhe të vërteta dhe për nxitjen e demokratizimit

Asambleja e Përgjithshme, (...) rikonfirmon detyrimin e të gjitha shteteve për marrjen e të gjitha masave të nevojshme për të garantuar që çdo shtetas të ketë të drejtën dhe mundësinë efektive për të marrë pjesë në zgjedhje në kushte të barabarta;

Rajonale

Këshilli i Evropës

Protokolli nr. 1 i Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, të vitit 1952

(3) Palët e Larta Kontraktuese marrin përsipër të organizojnë, në intervale të arsyeshme kohore, zgjedhje të lira, me votim të fshehtë, në kushte që sigurojnë shprehjen e lirë të mendimit të popullit për zgjedhjen e organit ligjvënës

Komisioni i Venecias, Kodi i Praktikës së Mirë në Çështjet Zgjedhore, i vitit 2002

(II.2.B) Elementet themelore të së drejtës zgjedhore dhe, në veçanti, të vetë sistemit të zgjedhor, përbërjes së komisioneve zgjedhore dhe caktimit të kufijve të zonave zgjedhore, nuk duhet të ndryshohen më pak se një vit përpara zgjedhjeve, ose duhet të shkruhen në kushtetutë, ose në një dokument ligjor të një niveli më të lartë se legjislacioni i zakonshëm. Raport shpjegues

(II.2.66) Një mënyrë për të shmangur manipulimin është përkufizimi në Kushtetutë ose në një ligj me hierarki më të lartë se sa legjislacioni i

zakonshëm i elementeve që janë më të rëndësishëm (sistemi zgjedhor, anëtarët e komisioneve zgjedhore, zonat zgjedhore ose rregullat për caktimin e kufijve të zonave zgjedhore).

Një zgjidhje tjetër më fleksibël do të ishte të theksohej në Kushtetutë se, në qoftë se do të ndryshohet ligji zgjedhor, për zgjedhjet e ardhshme do të aplikohet sistemi i vjetër – të paktën në qoftë se këto zgjedhje do të zhvillohen brenda vitit të ardhshëm – dhe pas kësaj do të hyjë në fuqi sistemi i ri.

Komisioni i Venecias, Deklarata Interpretuese për Stabilitetin e Ligjit Zgjedhor, e vitit 2005

- (1) Parimi, sipas të cilit elementet themelore të ligjit zgjedhor nuk duhet të jenë të hapura ndaj ndryshimeve për më pak se një vit para zgjedhjeve, nuk ka përparësi ndaj parimeve të tjera të Kodit të Praktikës së Mirë në Çështjet Zgjedhore.
- (2) Ai nuk duhet cituar për të mbështetur një situatë në kundërshtim me standardet e trashëgimisë zgjedhore evropiane ose për të penguar zbatimin e rekomandimeve të organizatave ndërkombëtare.
- (3) Ky parim ka të bëjë vetëm me rregullat themelore të ligjit zgjedhor, kur ato shfaqen në legjislacionin e zakonshëm.
- (4) Konsiderohen si themelore, veçanërisht, rregullat e mëposhtme:
 - vetë sistemi zgjedhor, pra rregullat për përkthimin e votave në mandate;
 - rregullat për anëtarësimin në komisione zgjedhore apo në organe të tjera, që organizojnë votimin;
 - caktimi i kufijve të zonave zgjedhore dhe i rregullave për shpërndarjen e mandateve mes tyre.
- (5) Në përgjithësi, çdo reformë për legjislacionin zgjedhor që do të zbatohet gjatë zgjedhjeve, duhet të bëhet në kohën e duhur në mënyrë që të zbatohet realisht në zgjedhje.

Komonuelthi i Shteteve të Pavarura

Asambleja Ndër-parlamentare e KSHP-së, Deklarata e Parimeve për Vëzhgimin Ndërkombëtar të Zgjedhjeve dhe Referendumet, e vitit 2008

(9) (...) Pas publikimit (shpalljes) të rezultateve zyrtare të zgjedhjeve (referendumit), por jo më vonë se dy muaj pas ditës së zgjedhjeve, kryetari ose nënkryetari i misionit ndërkombëtar të vëzhgimit duhet të paraqesë raportin përfundimtar mbi vëzhgimin ndërkombëtar të zgjedhjeve (ose referendumit) pranë organeve kolektive të KSHP-së.

(10) (...) Raporti përfundimtar mund të përfshijë rekomandime teknike për përmirësimin e procesit zgjedhor ose të referendumit në shtetin ku mbahen zgjedhjet (referendumi).

Organizata e Shteteve Amerikane

Asambleja e Përgjithshme e OSHA-së, Karta Demokratike Ndër-amerikane, e vitit 2001

V. Demokracia dhe misionet e vëzhgimit të zgjedhjeve

(23) (...) Shtetet anëtare, në ushtrimin e sovranitetit të tyre, mund të kërkojnë që Organizata e Shteteve Amerikane të ofrojë shërbime këshillimore ose ndihmë për fuqizimin dhe zhvillimin e institucioneve dhe proceseve të tyre zgjedhore, përfshirë dhe dërgimin e misioneve paraprake për këtë qëllim.

(24) (...) Misionet e vëzhgimit të zgjedhjeve paraqesin raportin mbi veprimtaritë e tyre, në kohën e duhur, pranë Këshillit të Përhershëm, përmes Sekretariatit të Përgjithshëm.

(25) Misionet e vëzhgimit të zgjedhjeve njoftojnë Këshillin e Përhershëm, përmes Sekretariatit të Përgjithshëm, nëse nuk ekzistojnë kushtet e nevojshme për zgjedhje të lira dhe të ndershme.

Standarde dhe dokumente të tjera

Deklarata e Parimeve për Vëzhgimin Ndërkombëtar të Zgjedhjeve, e vitit 2005

(7) Nga misionet ndërkombëtare të vëzhgimit të zgjedhjeve pritet që të lëshojnë në kohë deklarata të sakta dhe të paanshme për publikun (përfshirë dhe dhënien e kopjeve autoriteteve zgjedhore dhe subjekteve të tjera përkatëse kombëtare), duke paraqitur gjetjet e tyre, përfundimet dhe ndonjë rekomandim përkatës, që do të ndihmonte në përmirësimin e proceseve që kanë të bëjnë me zgjedhjet. Misionet duhet të njoftojnë publikisht praninë e tyre në një vend, përfshirë dhe mandatin e misionit, përbërjen dhe kohëzgjatjen e misionit, të bëjnë raporte periodike dhe të lëshojnë deklarata paraprake paszgjedhore të gjetjeve dhe një raport përfundimtar pas mbylljes së procesit zgjedhor. Gjithashtu, misionet ndërkombëtare të vëzhgimit të zgjedhjeve mund të zhvillojnë takime private me ata që merren me organizimin e zgjedhjeve të vërteta dhe demokratike në një vend, për

të diskutuar gjetjet, përfundimet dhe rekomandimet e misionit. Gjithashtu, misionet ndërkombëtare të vëzhgimit të zgjedhjeve mund t'u raportojnë organizatave të tyre përkatëse ndërqeveritare apo organizatave joqeveritare ndërkombëtare

(8) Organizatat që nënshkruajnë këtë Deklaratë dhe Kodin shoqërues të Sjelljes për Vëzhguesit Ndërkombëtarë të Zgjedhjeve zotohen se do të bashkëpunojnë mes tyre në ushtrimin e misioneve të vëzhgimit ndërkombëtar të zgjedhjeve. Vëzhgimi ndërkombëtar i zgjedhjeve mund të kryhet, për shembull, nga: misione individuale të vëzhgimit ndërkombëtar të zgjedhjeve; misione të posaçme të përbashkëta të vëzhgimit ndërkombëtar të zgjedhjeve apo misione të bashkërenduara të vëzhgimit ndërkombëtar të zgjedhjeve. Në të gjitha rastet, organizatat nënshkruese zotohen që do të bashkëpunojnë për të rritur në maksimum kontributin e misioneve të tyre të vëzhgimit ndërkombëtar të zgjedhjeve.

Deklarata e Parimeve Globale për Vëzhgimin dhe Monitorimin Jopartiak të Zgjedhjeve nga Organizatat e Qytetarëve, e vitit 2012

(4) Vëzhgimi dhe monitorimi jopartiak i zgjedhjeve nga organizatat e qytetarëve është mobilizimi i shtetasve në mënyrë jopolitike, të paanshme dhe mosdiskriminuese për të ushtruar të drejtën e tyre të pjesëmarrjes në çështjet publike, duke dëshmuar dhe raportuar mbi zhvillimet zgjedhore përmes: vlerësimit të pavarur, sistematik dhe gjithëpërfshirës të kornizave ligjore, institucioneve, proceseve dhe mjedisit politik në lidhje me zgjedhjet; analizës së paanshme, të saktë dhe të shpejtë të gjetjeve; karakterizimit të gjetjeve në bazë të standardeve më të larta etike për paanshmëri dhe saktësi; ofrimit të rekomandimeve të duhura për mbajtjen e zgjedhjeve të vërteta dhe demokratike; dhe mbështetjes së përmirësimeve në kornizat ligjore për zgjedhjet, zbatimin të tyre përmes administratës përkatëse zgjedhore dhe heqjes së pengesave për pjesëmarrjen e plotë të shtetasve në proceset zgjedhore dhe politike.

Plani i Veprimit i Bashkimit Evropian për të Drejtat e Njeriut dhe Demokracinë, për vitet 2015-19

(Veprimi V.32.b) Konsolidimi i praktikave më të mira për zbatimin e rekomandimeve të MVZ-ve të BE-së dhe të misioneve të vëzhgimit të zgjedhjeve të OSBE/ODIHR-it në dialogët politikë dhe veprimtaritë për mbështetjen e demokracisë të BE-së dhe vendeve anëtare të BE-së.

SHTOJCA B

Materiale dhe burime të tjera për zbatimin e rekomandimeve

OSBE

Manualet e ODIHR-it për Zgjedhjet

<http://www.osce.org/odihr/elections/119893>

- *Manual për vëzhgimin e zgjedhjeve: botimi i gjashtë, 2010.*
- *Manual për vëzhgimin e financimit të fushatave, 2015.*
- *Manual për vëzhgimin dhe nxitjen e pjesëmarrjes së pakicave kombëtare në proceset zgjedhore, 2014.*
- *Udhëzues për rishikimin e një kuadri ligjor për zgjedhjet, botimi i dytë, 2013.*
- *Manual për vëzhgimin e teknologjive të reja të votimit, 2013.*
- *Manual për vëzhgimin e regjistrimit të zgjedhësve, 2012.*
- *Manual për monitorimin e medias për Misionet e Vëzhgimit të Zgjedhjeve, 2012.*
- *Manual për Vëzhguesit Afatgjatë të Zgjedhjeve, 2007.*
- *Manual për monitorimin e pjesëmarrjes së grave në zgjedhje, 2004.*
- *Manual për Vëzhguesit Vendas të Zgjedhjeve, 2003.*

Opinione ligjore dhe komente të ODIHR-it në lidhje me zgjedhjet

<http://www.osce.org/odihr/elections/195256>

Legislationline.org – Bazë e të dhënave e ODIHR-it të legjislacioneve vendase për zgjedhjet <http://www.legislationline.org/>

Kurs për të mësuarit përmes mjeteve të komunikimit elektronik për vëzhguesit e OSBE/ODIHR-it

<http://www.odihrobserver.org/>

Dokumente të organeve vendimmarrëse të OSBE-së

<http://www.osce.org/resources/documents/decision-making-bodies>

Angazhimet e OSBE-së në fushën e dimensionit njerëzor (botimi i tretë):

Vëllimi 1, Përmbledhje tematike: <http://www.osce.org/odihr/76894>

Vëllimi 2, Përmbledhje kronologjike: <http://www.osce.org/odihr/76895>

Kombet e Bashkuara

Bazë e të dhënave të Përmbledhjes së Traktateve të OKB-së
<https://treaties.un.org/>

Organizmat e të drejtave të njeriut të OKB-së
<http://www.ohchr.org/EN/HRBodies/Pages/HumanRightsBodies.aspx>

Procedura të posaçme të Këshillit të të Drejtave të Njeriut
<http://www.ohchr.org/EN/HRBodies/SP/Pages/Welcomepage.aspx>

Rishikimi Periodik Universal (RPU)
<http://www.ohchr.org/EN/HRBodies/UPR/Pages/UPRMain.aspx>

Bazë e të dhënave të RPU-së me rekomandimet e RPU-së dhe zotimet vullnetare
<http://www.upr-info.org/database/>

Këshilli i Evropës

Bazë e të dhënave të praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së
[http://hudoc.echr.coe.int/eng#{"article":\["P1-3"\]}](http://hudoc.echr.coe.int/eng#{)

Dokument informues i GJEDNJ-së për të drejtën për zgjedhje të lira
http://www.echr.coe.int/Documents/FS_Free_elections_ENG.pdf

Bazë e të dhënave të Komisionit të Venecias – Legjislacioni për zgjedhjet
<http://www.venice.coe.int/VOTA/en/start.html>

Opinione dhe studime të Komisionit të Venecias
http://www.venice.coe.int/WebForms/documents/by_opinion.aspx

Raporte të GRECO-s për vlerësimin dhe përputhshmërinë
http://www.coe.int/t/dghl/monitoring/greco/documents/index_en.asp

SHTOJCA C

Lista e shkurtimeve

KNPM	Konventa Ndërkombëtare për Mbrojtjen e të Drejtave të të Gjithë Punëtorëve Migrantë dhe Anëtarëve të Familjeve të Tyre
INDAZ	Instituti Ndërkombëtar për Demokraci dhe Asistencë Zgjedhore
MVN	Misioni i vlerësimit të nevojave
OJQ	Organizatë joqeveritare
OSHA	Organizata e Shteteve Amerikane
ODIHR	Zyra e OSBE-së për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut
KP	Këshilli i Përhershëm i OSBE-së
PLM	Përfaqësuesi i OSBE-së për Lirinë e Medias
DUDNJ	Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut
OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara
KKBKK	Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit
PNUD	Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara
RUP	Rishikimi universal periodik
Komisioni i Venecias	Komisioni Evropian për Demokraci përmes Ligjit, Këshilli i Evropës
BE	Bashkimi Evropian
MT	Misionet në terren të OSBE-së
GSHKiEKK	Grupi i Shteteve të Këshillit të Evropës kundër Korrupsionit
KLPK	Komisioneri i Lartë i OSBE-së për Pakicat Kombëtare
KiDNJ	Komiteti i Dimensionit Njerëzor i OSBE-së
TZKDNJ	Takimi Zbatues i Komitetit të Dimensionit Njerëzor të OSBE-së
SDNJ	Seminari për Dimensionin Njerëzor i OSBE-së
KDNA	Karta Demokratike Ndër-amerikane
PNDPCP	Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike
KNEFDR	Konventa Ndërkombëtare për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racial

KNPM	Konventa Ndërkombëtare për Mbrojtjen e të Drejtave të të Gjithë Punëtorëve Migrantë dhe Anëtarëve të Familjeve të Tyre
International IDEA	International Institute for Democracy and Electoral Assistance
NAM	Needs Assessment Mission
NGO	Non-governmental Organization
OAS	Organization of American States
ODIHR	OSCE Office for Democratic Institutions and Human Rights
PC	OSCE Permanent Council
RFoM	OSCE Representative on Freedom of the Media
UDHR	Universal Declaration of Human Rights
UN	United Nations
UNCAC	UN Convention against Corruption
UNDP	UN Development Programme
UPR	Universal Periodic Review
Venice Commission	The Council of Europe's European Commission for Democracy through Law

Parimet e ODIHR-it për zbatimin e rekomandimeve

- ODIHR-i nxit dhe mbështet zbatimin e rekomandimeve që bëjnë misionet e vëzhgimit të zgjedhjeve, për të përmbushur të drejtat demokratike sipas zotimeve të marra në marrëveshjet politike dhe në traktatet e detyrueshme me ligj.
- ODIHR-i jep mbështetje për zbatimin e rekomandimeve vetëm me kërkesë të shtetit pjesëmarrës të interesuar.
- ODIHR-i ndërmerr veprimtari për zbatimin e rekomandimeve në mënyrë objektive, të paanshme, neutrale dhe të pavarur, duke pranuar se përgjegjësinë kryesore për organizimin e zgjedhjeve e kanë shtetet pjesëmarrëse.
- ODIHR-i i jep prioritet asistencës për zbatimin e rekomandimeve në përputhje me nevojat dhe interesat e shtetit pjesëmarrës, me kohën në dispozicion para zgjedhjeve të radhës dhe burimet që ka në dispozicion ODIHR-i.
- ODIHR-i mbështet praktikën e mirë të reformës zgjedhore, duke punuar sipas ciklit zgjedhor, duke inkurajuar vullnetin politik, duke mbështetur kapacitetet e qëndrueshme të administrimit të zgjedhjeve, duke nxitur konsultimet publike dhe gjithëpërfshirjen, duke iu referuar angazhimeve të OSBE-së dhe detyrimeve e standardeve të tjera ndërkombëtare, duke u mbështetur në ekspertizën kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe duke inkurajuar hartimin e planeve, raportimin publik dhe mekanizmat e rishikimit.
- ODIHR-i nxit pluralizmin politik dhe pjesëmarrjen e grupeve të papërfaqësuar sa duhet në proceset e zbatimit të rekomandimeve, si mjet për të inkurajuar mundësi të barabarta për pjesëmarrje në zgjedhje.
- ODIHR-i bashkëpunon me organizata të tjera vëzhguese ndërkombëtare dhe grupe të vëzhguesve qytetarë për të inkurajuar mbështetjen e bashkërenduar të zbatimit të rekomandimeve.
- ODIHR-i ndërmerr veprimtari për zbatimin e rekomandimeve në mënyrë të hapur dhe transparente.
- ODIHR-i i rishikon rregullisht praktikat e veta të zbatimit të rekomandimeve për të identifikuar nevojën për përmirësime të mundshme.
- ODIHR-i i inkurajon shtetet pjesëmarrëse të raportojnë rreth zbatimit të rekomandimeve për zgjedhjet përmes strukturave të OSBE-së, si dhe mekanizmave të tjerë universale dhe rajonale.